

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5703
E premte, 15 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Në Strasburg kërkohet që të vazhdohet dialogu Kosovë - Serbi

IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MAHIR JAGXHILLAR I FAQE 4-5



LIGJI PËR PAGAT DUHET TË DEKRETOHET

- Presidenti duhet ta nënshkruajë Ligjin për pagat

Ministri i Administratës Publike (MAP), Mahir Jagxhillar, ka bërë me dije se në Ligjin për pagat të gjithë sektorët janë trajtuar barabartë duke u bazuar në specifikat e vendit të punës, përgatitjes profesionale si dhe sipas parimit paga e njëjtë për punë

të njëjtë. Ai ka thënë se nuk ka ligj të përkryer, prandaj edhe Ligji për pagat mund të plotësohet ose ndryshohet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jagxhillar ka vlerësuar se Ligji për pagat duhet të dekretohet nga presidenti pasi,

sipas tij, ky ligj krijon disiplinë dhe stabilitet financiar. Ministri Jagxhillar ka theksuar se me këtë ligj pagat më nuk do të përcaktohen me vendime të ndryshme nga institucionet si dhe rritja e pagave më nuk do të përdoret për agenda politike

Delegacioni shtetëror miraton platformën për bisedime me Serbinë

Liderët institucionalë dhe delegacioni shtetëror për dialog i kanë harmonizuar të enjten qëndrimet e tyre rreth platformës për bisedime me Serbinë. Sipas anëtarëve të delegacionit shtetëror, platforma paraqet unifikimin e qëndrimit të institucioneve dhe delegacionit shtetëror në raport me pozicionin e Kosovës në bisedime me Serbinë. Po ashtu, platforma parasheh edhe reciprocitet në të drejta



Reka: Këshilla e ShBA-së për pezullimin e taksës rikonfirmon pozitën e Kosovës në dialog

IFAQE 7

AKTUALE

QENDRAT KULTURORE TË DIASPORËS, TË DOMOSDOSHME PËR FUQIZIMIN E RAPORTEVE ME DIASPORËN F.11

NË PRAG TË 17 SHKURTIT FËMIJËT VIZITOJNË KUVENDIN E KOSOVËS F.6

PUNËTORËT E KEK-ut DHE TË SHËRBIMIT KORREKTUES KUNDËRSHTOJNË LIGJIN PËR PAGAT F.8

EKONOMI

KOMPLETIMI I INFRASTRUKTURËS, I NEVOJSHËM PËR ZHVILLIMIN E BIZNESEVE TË DRENASIT

F.9

MUNDËSI PUNËSIMI DHE TRAJNIMI PËR MË SHUMË SE 500 PUNËKËRKUES F.9

KULTURË

HOTI: QEVERIA PËR HERË TË PARË KA PROGRAM TË GARËS PËR 340 MIJË NXËNËS F.11

SPORT

HYSENI: TREPÇA '89 SYNON DALJEN NË EVROPË F.18

FUTBOLLI RIKTHEHET ME NDESHJEN KEK-U - LLAPI

F.18

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Parlamenti shqiptar voton anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO

TIRANË, 15 SHKURT - Parlamenti i Shqipërisë miratoi në unanimitet ratifikimin e Protokollit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, në një seancë ku nuk munguan sërisht tensionet dhe incidentet. Deputeti demokrat Edi Paloka sulmoi kryeministrin Edi Rama, duke i hedhur atij bojë në fytyrë dhe në trup. Reagimi i deputetit Paloka erdhi pasi kryeministri e cilësoi kryetarin e opozitës, Lulzim Basha, "një fëmijë që nuk di se ç'flet", pas fjalimit të tij që nisi me çështjen e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO

dhe përfundoi me akuza ndaj qeverisë për lidhje të saj me krimin.

Në seancën e së enjtes ishte i pranishëm edhe kryetari i Parlamentit maqedonas Talat Xhaferri. "Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut është një vlerë e shtuar në progresin e rajonit për zhvillim, paqe dhe stabilitet", tha në fjalën e tij, në hapje të seancës, kryetari i Parlamentit shqiptar, Gramoz Ruçi.

Kryeministri Edi Rama foli për "një moment i cili përkon me një kohë të artë të marrëdhënieve

ndëretnike mes dy popujve shtetformues të Maqedonisë së Veriut".

Kryeministri vuri theksin në rolin e veçantë të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. "Pa shqiptarët s'do të kishte Maqedoni të Veriut. Nëse sot, situata në Maqedoninë e Veriut është më e mirë se asnjëherë tjetër në aspektin e marrëdhënieve politike ndëretnike, kjo i dedikohet në radhë të parë rolit konstruktiv të lidershit politik shqiptar në atë vend, si dhe, padiskutim, lidershit vizionar dhe kurajoz të kryeministrit Zoran Zaev, të cilin



gjej rastin ta përshëndes solemnisht nga kjo seancë për arritjen historike të anëtarësimit në NATO

dhe ta përgëzoj edhe një herë për dorën e shtrirë të vëllazërisë në drejtim të shqiptarëve", tha Rama.

Stoltenbergu: Po shqyrtojmë shkallën e bashkëpunimit me Kosovën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se taksa 100 për qind për mallrat e Serbisë dhe Bosnjës e ka bërë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë edhe më të vështirë dhe është duke kthyer procesin në rrugë të gabuar dhe kjo është arsyeja se pse ne tani kemi vendosur ta shqyrtojmë shkallën e bashkëpunimit tonë me Kosovën

BRUKSEL, 15 SHKURT - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë të enjten se NATO-ja është duke shqyrtuar shkallën e bashkëpunimit me Kosovën për shkak të tarifës prej 100 përqindësh që Qeveria e Kosovës ua ka vënë importeve të Serbisë dhe Bosnjës. Sa i përket tarifës prej 100 përqindësh, që Qeveria e Kosovës ka vënë në produktet e Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës, Stoltenbergu ka thënë se kjo masë "e ka bërë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë edhe më të vështirë dhe është duke kthyer procesin në rrugë të gabuar".

"Ky është qëndrimi im ashtu sikurse i shumë aleatëve të NATO-s. Shtetet e Bashkuara kanë qenë shumë të qarta sa i përket tarifës shumë të lartë që tashmë është vënë në produktet e Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës. Kjo është arsyeja

se pse ne tani kemi vendosur që ta shqyrtojmë shkallën e bashkëpunimit tonë me Kosovën. Mirëpo, ashtu siç kam deklaruar edhe më parë, kjo nuk ka të bëjë me KFOR-in. KFOR-i do të vazhdojë ashtu siç është paraparë me mandatin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, andaj ne do ta shqyrtojmë përkrahjen dhe karakterin e bashkëpunimit të NATO-s jashtë KFOR-it", ka thënë ai, ka njoftuar rel.

Stoltenbergu, po ashtu, ka thënë se aleanca duhet mbështetur dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit, që zhvillohet me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian në Bruksel. Kreu i NATO-s ka përmendur se pas transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri, NATO-ja është duke rishikuar shkallën e bashkëpunimit me këtë Forcë. Ai ka thënë se disku-



timet për këtë çështje janë duke vazhduar dhe se vendimi do të merret më së largu në fillim të pranverës. "Jemi në kontakt të ngushtë me autoritetet në Prishtinë gjatë gjithë procesit. Unë kam treguar në të dyja takimet me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe presidentin Hashim Thaçi se vendimi për transformimin e FSK-së në ushtri është marrë në kohë të papërshtatshme. Unë jam deklaruar disa herë publikisht dhe ky është mendimi im",

është shprehur ai. Stoltenbergu ka theksuar se ekziston marrëveshja e vitit 2013, sipas së cilës, Kosova zotohet se nuk do të dërgojë forca të FSK-së në veri të Kosovës pa pajtimin e KFOR-it. "Sa i përket veriut, kjo gjë është bërë e qartë përmes një marrëveshjeje më 2013 dhe presim që ajo të vazhdojë. Kjo është ajo pse ne kemi dhënë një mesazh aq të qartë pse autoritetet në Prishtinë duhet t'i respektojnë marrëveshjet që i kemi bërë

bashkë me ata", ka deklaruar ai. Marrëveshja që ka përmendur Stoltenbergu thuhet se është arritur përmes një këmbimi letrash më 2013 ndërmjet sekretarit të atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen dhe atëbotë kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi.

Kreu i aleancës veriatlantike ka thënë gjatë konferencës për media në Bruksel, se misioni i KFOR-it në Kosovë vazhdon të jetë i pandryshuar, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. "Ne jemi aty për të siguruar ambient të sigurt për të gjithë njerëzit në Kosovë dhe ajo është çfarë jemi duke bërë tani", ka shtuar Stoltenbergu.

Aleanca Veriatlantike pati shprehur skepticizëm në kohën kur është transformuar FSK-ja në ushtri, duke thënë se një gjë e tillë po ndodh në kohë të papërshtatshme, derisa Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë miratuar votën për këtë proces. Kuvendi i Kosovës ka miratuar më 14 dhjetor të vitit të kaluar ligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri.

Dy ditë zie për 14 të vdekurit në aksidentin afër Shkupit

SHKUP, 15 SHKURT - Shtatë persona që i mbijetuan aksidentit në autostradën Shkup - Tetovë janë në rrezik për jetën, ndërsa rreth tridhjetë të tjerë janë në gjete më stabile, sipas të dhënave të institucioneve shëndetësore të Maqedonisë së Veriut, që tashmë kanë konfirmuar edhe bilancin për katërmbëdhjetë të vdekur.

Aksidenti i rëndë rrugor ka ndodhur të mërkurën pasdite në autostradën Shkup - Tetovë, afër fshatit Llaskarcë, 10 kilometra nga kryeqendra e Maqedonisë së Veriut, ku një autobus i linjës Shkup - Gostivar ka dalë nga rruga dhe është rrokullisur në një hendek përgjatë autostradës. Në autobus besohet të kenë qenë rreth

50 persona, kryesisht punonjës të administratës dhe të tjerë që po ktheheshin në shtëpitë e tyre.

Aktualisht, në spitalin e qytetit janë të shtrirë katër persona në repartin e trajtimit intensiv. Ata janë në rrezik për jetën. Tre të tjerë janë në Qendrën Klinike Universitare, po ashtu në gjendje të rëndë.



Përfaqësuesit institucionalë dhe delegacioni shtetëror për dialog i kanë harmonizuar qëndrimet për platformën e bisedimeve me Serbinë

Delegacioni shtetëror miraton platformën për bisedime me Serbinë

Liderët institucionalë dhe delegacioni shtetëror për dialog i kanë harmonizuar të enjten qëndrimet rreth platformës për bisedime me Serbinë. Sipas anëtarëve të delegacionit shtetëror, platforma paraqet unifikimin e qëndrimit të institucioneve dhe delegacionit shtetëror në raport me pozicionin e Kosovës në bisedime me Serbinë. Po ashtu, platforma parasheh edhe reciprocitet në të drejta

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 SHKURT - Delegacioni shtetëror për dialog të enjten unanimisht e ka votuar platformën për dialog, pas konsultimeve me presidentin, kryeparlamentarin dhe kryeministrin. Pas miratimit të kësaj platforme, bashkëkryesuesit e delegacionit kanë thënë se kjo platformë paraqet qëndrimin zyrtar të Republikës së Kosovës në dialogun me Serbinë.

Fatmir Limaj, një nga bashkëkryesuesit e ekipit të delegacionit shtetëror, ka thënë se platforma tani ka marrë mbështetjen institucionale. "Mund t'ju njoftoj se delegacioni i Kosovës e ka platformën. Platforma paraqet një punë të jashtëzakonshme që ka bërë delegacioni prej se është zgjedhur nga Kuvendi. Jemi konsultuar me të gjitha institucionet dhe me

shumë ekspertë. Të gjithë anëtarët e delegacionit kanë bërë një punë të madhe, për çfarë u shpreh mirënjohje për angazhimin që kanë pasur", ka thënë Limaj, duke treguar se sot (e premte) këtë platformë do t'ia paraqesin Kuvendit. "Kemi marrë edhe sugjerimet e krerëve të shtetit dhe, përfundimisht, me votë unanime, platforma është miratuar. Nesër do t'ia dorëzojmë kryetarit të Kuvendit dhe, përmes tij, Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që deputetët të kenë mundësi përmes debatit të vijnë deri te votimi i platformës, e cila do ta paraqesë qëndrimin zyrtar dhe të vetëm të Republikës së Kosovës në dialogun për njohjen, që mund të ndodhë me Republikën e Serbisë", ka thënë ai. Limaj ka treguar se në platformë parashihet reciprociteti në të drejta të minoriteve në të dyja shtetet. "Zyrtarisht të premtën dokumenti do të bëhet publik, në

Mustafa: Për LDK-në kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se për këtë parti kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm. "Për LDK-në kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm. Është i ndaluar dialogu për kufijtë, për territorin, për pavarësinë e shpallur më 17 shkurt 2008. Hapja e dialogut për kufijtë është vetagresion ndaj shtetit dhe territorit të Kosovës. Nëse dikujt i ka mbetur të bëjë pazare me korrigjimin e kufijve, ai mund t'i korrigjojë vetëm mezhdat e arave të veta, jo kufijtë e Kosovës", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

të cilin janë të përfshira të gjitha shqetësimet, debatet dhe ndjeshmëritë që e kanë karakterizuar këtë temë. Kemi marrë parasysh qëndrimet e forcave politike, edhe të figurave të rëndësishme të vendit tonë. Mbi të gjitha, jemi bazuar në dokumentet mbi të cilat është ndërtuar shteti i Kosovës: Kushtetuta, Deklarata e Pavarësisë dhe Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare. Në një paragraf të platformës parashihet reciprociteti i plotë në të drejtat e minoriteteve në Kosovë dhe në Serbi", ka deklaruar Limaj. Kurse bashkëkryesuesi tjetër i delegacionit, Shpend Ahmeti, ka treguar se çdo gjë është analizuar mirë në këtë dokument. "Sot i

patëm konsultimet përfundimtare. Besoni se fjali për fjali i kemi diskutuar. Në hyrje të platformës thuhet se ky është qëndrimi zyrtar i Republikës së Kosovës dhe ky është i vetmi qëndrim që Kosova ka karshi dialogut. Natyrisht se ky është qëndrimi i parë formal i Kosovës karshi dialogut. Gjatë ditëve të tjera ne do t'ua dërgojmë dhe subjekteve opozitare këtë platformë që ta kenë edhe ato, nëse ka nevojë për konsultime shtesë", ka thënë ai.

Ahmeti i ka ftuar edhe subjektet e tjera opozitare që ta votojnë këtë dokument. "I kam dëgjuar të gjitha deklaratat e deputetëve të Vetëvendosjes dhe të LDK-së. Le

ta lexojnë një herë platformën, mandej të mendojnë për ta votuar", është shprehur Ahmeti. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pas konsultimeve me ekipin negociator në dialogun me Serbinë, ka thënë se është arritur marrëveshje që platforma e dialogut të kalojë në Kuvendin e Kosovës. "Përfundimisht kemi një pajtim për platformën e Kosovës në dialog. Procedurë tjetër është konfirmimi nga delegacioni shtetëror që të mund të kalojë në Kuvend. Mendoj se platforma është një dokument i qëndrueshëm i parimeve dhe qëndrimeve që ka Kosova në dialog. Buron nga Kushtetuta, i obligohet dhe mbron Kushtetutën e vendit. Personalisht i jap përkrahje", ka thënë Haradinaj. Ai ka vlerësuar se platforma është shumë e rëndësishme për të ardhmen e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, duke i bërë thirrje edhe opozitës që ta përkrahë këtë platformë në kuvend. "Edhe nëse Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Vetëvendosje nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në delegacion, mendoj se ata mund ta japin kontributin e vet qoftë duke e përkrahur platformën apo duke dhënë mendimet e tyre për platformën", është shprehur kryeministri.



Ora e parë e mësimit sot do t'i kushtohet pavarësisë së Kosovës

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë vendim që sot (e premte) në të gjitha shkollat

fillore dhe të mesme të Kosovës ora e parë e mësimit t'i kushtohet historikut të pavarësisë së Republikës së Kosovës, sakrificës së popullit shqiptar dhe

kontributit të bashkësisë ndërkombëtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Këtë vendim ministri Bytyqi e ka marrë në prag të 11-vjetorit të

shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të zgjerimit të njohurive të nxënësve për këtë ngjarje të rëndësishme.



Flet për "Epokën e re", Mahir Jagxhillar

Ligji për pagat du

- Presidenti duhet ta nënshkruajë Ligjin për pagat

Ministri i Administratës Publike (MAP), Mahir Jagxhillar, ka bërë me dije se në Ligjin për pagat të gjithë sektorët janë trajtuar barabartë duke u bazuar në specifikat e vendit të punës, përgatitjes profesionale si dhe sipas parimit paga e njëjtë për punë të njëjtë. Ai ka thënë se nuk ka ligj të përkryer, prandaj edhe Ligji për pagat mund të plotësohet ose ndryshohet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jagxhillar ka vlerësuar se Ligji për pagat duhet të dekretohet nga presidenti pasi, sipas tij, ky ligj krijon disiplinë dhe stabilitet financiar. Ministri Jagxhillar ka theksuar se me këtë ligj pagat më nuk do të përcaktohen me vendime të ndryshme nga institucionet si dhe rritja e pagave më nuk do të përdoret për agjenda politike



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 SHKURT - Ministri i Administratës Publike (MAP), Mahir Jagxhillar, ka thënë të enjten se me miratimin e Ligjit për pagat, Ligjit për organizimin e administratës shtetërore dhe Ligjit për zyrtarët publikë, janë krijuar kushte për një administratë publike më efikase, më transparente, më profesionale dhe të depolitizuar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se aprovimi i këtyre tri ligjeve në pako ka plotësuar edhe kriteret e Agjendës Evropiane të Reformave. Ministri Jagxhillar ka treguar se në Ligjin për pagat sektorët janë trajtuar barabartë duke u bazuar në specifikat e vendit të punës, përgatitjes profesionale si dhe sipas parimit paga e njëjtë për punë të njëjtë. Megjithatë, ai ka thënë se nuk ka ligj të përkryer, prandaj edhe ky ligj mund të plotësohet ose ndryshohet.

Jagxhillar ka vlerësuar se Ligji për pagat duhet të dekretohet nga presidenti sepse, sipas tij, ky ligj krijon disiplinë dhe stabilitet financiar. "Ligj të përkryer nuk ekziston. Ligjet në vazhdimësi plotësohen ose ndryshohen. Sigurisht se Zyra e Presidentit ka drejtë t'i shfrytëzojë mundësitë e veta kushtetuese për amendamente shtesë me qëllim të sigurimit që ligji të jetë plotësisht në harmoni me kushtetutën e

shtetit. A duhet të nënshkruhet Ligji për pagat? Mendoj se po. Nga ana tjetër, në qoftë se ka elemente kushtetuese për plotësim, atëherë të plotësohet. Nënshkrimi i ligjit për të hyrë në fuqi është i rëndësishëm sepse për herë të parë Kosova do të ketë një ligj themelor për paga", ka deklaruar ai, duke shtuar se me këtë ligj pagat më nuk do të përcaktohen me vendime të ndryshme dhe rritja e pagave nuk do të përdoret për agjenda politike.

Në këtë intervistë ministri Jagxhillar ka folur edhe për dialogun me Serbinë, me ç'rast ka thënë se për finalizimin e këtij procesi kërkohet konsensus politik. Ai ka shprehur optimizëm se aprovimi i Platformës për dialogun do ta ndihmojë Kosovën në këtë aspekt. "Në këtë aspekt ka nevojë për unifikim të qëndrimeve midis udhëheqësve, gjithashtu edhe midis partive politike, pa marrë parasysh a janë në pozitë apo opozitë. Sepse shteti dhe interesi i shtetit është mbi të gjithë. Besoj se edhe aprovimi i Platformës për dialogun do të na ndihmojë në këtë rast. Nga ana tjetër, mendimet dhe sugjerimet e të gjitha shteteve mike, sidomos të ShBA-së dhe të BE-së, gjithmonë duhet të trajtohen me përkushtim", është shprehur ministri Jagxhillar.

"Epoka e re": Z. Jagxhillar, Ministria e Administratës

Publike ka hartuar Ligjin për pagat i cili ka marrë edhe aprovimin e Kuvendit të Kosovës. Megjithatë, ky ligj ka sjellë pakënaqësi të shumta. Pse po kundërshtohet Ligji për paga, nuk janë trajtuar siç duhet kategoritë e përfshira në të?

Jagxhillar: Ligji për pagat në sektorin publik është pjesë e pakos ligjore të reformës së administratës publike bashkë me Ligjin për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencitë si dhe Ligjin për zyrtarët publikë. Me këto ligje nga aspekti i organizimit janë trajtuar të gjitha institucionet e administratës shtetërore, ndërsa nga aspekti i punës të gjithë zyrtarët sipas definicionit zyrtarët publik dhe të gjithë përfituesit me pagë (mbi 80 000 zyrtarë) nga buxheti Republikës së Kosovës. Ministria e Administratës Publike (MAP) ka propozuar një variant i cili ka kaluar nga një

proces i gjerë i diskutimeve publike, pastaj është plotësuar me amendamente nga Kuvendi i Kosovës. Ne si Ministri e Administratës Publike kemi menduar t'i trajtojmë të gjithë barabartë, duke u bazuar në specifikat e vendit të punës dhe përgatitjes profesionale si dhe sipas parimit paga e njëjtë për punë të njëjtë.

"Epoka e re": Sektorë të caktuar janë ankuar dhe kanë kërkuar nga presidenti që të mos e dekretojë këtë ligj. A duhet ta nënshkruajë presidenti Ligjin për pagat?

Jagxhillar: Ligj të përkryer nuk ekziston. Ligjet në vazhdimësi plotësohen ose ndryshohen. Sigurisht se Zyra e Presidentit ka drejtë t'i shfrytëzojë mundësitë e veta kushtetuese për amendamente shtesë me qëllim të sigurimit që ligji të jetë plotësisht në harmoni me kushtetutën e

shtetit. A duhet të nënshkruhet Ligji për paga? Mendoj se duhet. Nga ana tjetër, në qoftë se ka elemente kushtetuese për plotësim, atëherë të plotësohet. Nënshkrimi i ligjit për të hyrë në fuqi është i rëndësishëm sepse për herë të parë Kosova do të ketë një ligj themelor për paga i cili është vazhdimësi e produktit dy ligjeve të tjera, Ligjit për organizimin e administratës shtetërore dhe Ligjit për zyrtarët publikë. Me këtë ligj do të krijohet disiplina dhe stabilitet financiar, sepse vlera e koeficientit apo rritja eventuale e pagave do të bëhet sipas Ligjit të buxhetit duke u bazuar në zhvillimin ekonomik, ndërsa ndarja e shtesave dhe elementeve të tjera të pagave do të bëhet sipas rregulloreve bazuar në ligj. Në këtë mënyrë, më pagat nuk do të përcaktohen me vendime të ndryshme nga institucionet sipas vlerësimeve të lira të

het të dekretohet



brendshme apo rritja e pagave të përdoret për agjenda politike.

"Epoka e re": Çfarë do të ndodhë me këtë ligj nëse nuk dekretohet nga presidenti?

Jagxhillar: Procedura e aprovimit dhe dekretimit të ligjeve është e rregulluar me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Në këtë proces çdo institucion ka rëndësinë dhe kompetencat e veta. Pa dyshim qëllimi kryesor është që ligjet të jenë në harmoni me Kushtetutën dhe sa më të zbatueshme.

"Epoka e re": Ministër, miratimi i Ligjit për organizimin e administratës shtetërore, Ligji për zyrarët publikë dhe Ligji për pagat janë esenciale për zhvillimin e reformave në administratën publike. Si është duke u zhvilluar ky proces dhe kur do ta ketë shteti i Kosovës një administratë të reformuar dhe të depolitizuar?

Jagxhillar: Siç shihet, te Ligji për organizimin e administratës publike dhe Ligji për zyrarët publikë në procedurat parlamentare nuk kanë ndodhur ndryshime të mëdha. Këto ligje paraprakisht kanë marrë vlerësimin e duhur nga Komisioni Evropian dhe nga SIGMA/OECD. Me aprovimin e këtyre tri ligjeve në pako e kemi plotësuar edhe agjendën evropiane të reformave në kuadër të administratës publike dhe kemi plotësuar kushtet për përfitimin e mjeteve financiare nga projekti i KE-së për mbështetje sektoriale buxhetore. Por, ç'është më e rëndësishme, janë krijuar kushte optimale që, bashkë me zbatimin e këtyre ligjeve, të kemi një administratë publike më efikase, më transparente, më profesionale dhe të depolitizuar nga aspekti i marrjes së vendimeve dhe funksionimit të administratës.

"Epoka e re": Meqenëse ju jeni edhe pjesë e ekipit shtetëror për dialogun me Serbinë, si e shihni vazhdimin e këtij procesi dhe a duhet të hiqet taksa ndaj produkteve serbe ashtu siç po kërkon ShBA-ja?

Jagxhillar: Duke qenë pjesë e ekipit shtetëror për dialog, mendoj se kërret e shtetit duhet të arrijnë deri te një vendim i

përbashkët i cili hap rrugën dhe e përforcon pozitën e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Çdo sukses është gjithmonë i lidhur drejtpërdrejt me unitetin e brendshëm dhe konsensusin e gjerë shoqëror dhe politik. Në këtë aspekt ka nevojë për unifikim të qëndrimeve midis udhëheqësve, gjithashtu edhe midis partive politike, pa marrë

parasysh a janë në pozitë apo opozitë. Sepse shteti dhe interesi i shtetit është mbi të gjithë. Besoj se edhe aprovimi i Platformës për dialogun do të na ndihmojë në këtë rast. Nga ana tjetër, mendimet dhe sugjerimet e të gjitha shteteve mike, sidomos të ShBA-së dhe të BE-së, gjithmonë duhet të trajtohen me përkushtim.

Reka: Këshilla e ShBA-së për pezullimin e taksës rforcon pozitën e Kosovës në dialog

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 SHKURT - Ish-diplomati dhe profesori i së drejtës ndërkombëtare, Blerim Reka, ka thënë se taksa ndaj produkteve serbe ka arritur qëllimin. Reka ka thënë të enjten se pezullimi i taksës është një dalje me faqe të bardhë për shtetin e Kosovës. Ai ka theksuar se këshilla miqësore amerikane për pezullim të taksës, jo tërheqje, rikonfirmon sovranitetin e Kosovës dhe rforcon pozitën e saj në finalen e dialogut me Serbinë. "Sovraniteti ushtrohet nga Qeveria, si kur vendoset ashtu edhe kur pezullohet taksa. Këtë e kuptoj edhe Serbia në tre muajt e fundit. Taksa arriti qëllimin: pamundësinë e vazhdimin të mëtejshëm të dialogut asimetrik të Brukselit, që udhëhiqej vetëm nga BE-ja. Që atëherë, edhe me ShBA-në. Andaj këshilla miqësore amerikane

për pezullim, jo tërheqje, rikonfirmon sovranitetin e Kosovës dhe rforcon pozitën e saj negociatore në finalen e dialogimit. Si kompensim, Kosova mund ta kërkojë ndryshimin e preambulës kushtetuese serbe. ShBA-ja kërkon marrëveshje finale për mbylljen e problemit të parë dhe të fundit ballkanik. Pezullimi i taksës është pra një exit strategy me faqe të bardhë, për t'i parandaluar akuzat serbe për 'Kosovën prishëse të procesit', e duke shmangur Kosovën nga pozita që e kishte në Rambuje Serbia karshi ndërkombëtarëve. Aleati ynë historik dhe aktual peshon më shumë se një masë tregtare", ka thënë Blerim Reka, profesori i së drejtës ndërkombëtare. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë shtuar presionin ndaj Kosovës për heqjen e taksës për mallrat serbe. Ambasadori i ShBA-së, Philip S. Kosnett, sërish këtë

javë, gjatë një takimi me presidentin Hashim Thaçi, ka kërkuar që Kosova t'i heqë pengesat dhe të vazhdohet dialogu me Serbinë. Po këtë javë përmes një letre zyrtarë e lartë amerikane e kanë vlerësuar të pabesueshëm faktin se Kosova po injoron këshillën e tyre për heqjen e taksës. Presidenti Hashim Thaçi ka bërë thirrje që taksa të hiqet në mënyrë që të dëgjohet këshilla e ShBA-së dhe dialogu me Serbinë të vazhdojë. Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka kërkuar që taksa të pezullohet për 120 ditë. Por kryeministri Ramush Haradinaj ka përsëritur qëndrimin se nuk do ta heqë taksën. Qeveria e Kosovës më 6 nëntor të vitit të kaluar fillimisht kishte vendosur taksë doganore 10 për qind për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Kjo taksë doganore u ngre në 100 për qind më 21 nëntor.



Në prag të 17 shkurtit fëmijët vizitojnë Kuvendin e Kosovës

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në prag të 11-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, ka prituri të enjten

në ambientet e Kuvendit disa fëmijë. Kryeparlamentari Veseli ka thënë se kjo vizitë është një kujtim i mirë për fëmijët, të cilët do ta trashë-

gojnë shtetin e Kosovës. "Në prag të 11-vjetorit të pavarësisë, Kuvendi i Kosovës u zbukuroa me zërat dhe buzëqeshjet e fëmijëve. Një

kujtim i bukur për ta, që nesër do ta trashëgojnë shtetin e Kosovës", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



205 raste emergjente në QKUK

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Klinika Emergjente për 24 orë ka pasur 205 pacientë që kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Në dhomën e kujdesit të avancuar mjekësor ka pasur 48 raste, 42 në dhomën kirurgjike, 71 raste në dhomën internistike dhe 37 raste ortopedike. Ka pasur, po ashtu, shtatë intervenime të shpejta kirurgjike, gjashtë raste të pacientëve të aksidentuar. Gjithsej nga emergjenca ka pasur 30 pranime në klinika të ndryshme, 10 raste në degët kirurgjike, 16 në dhomat internistike, dy në ortopedi dhe dy në mjekimin intensive qendror. Në Emergjencën e Klinikës

Pediatrike ka pasur gjithsej 91 raste. Sipas raportit të kësaj klinike, ka pasur 32 pranime të fëmijëve për mjekim të mëtejshëm. Nga pediatri janë kontrolluar edhe 99 fëmijë të tjerë që kanë marrë shërbime te pediatri e profileve të ndryshme mjekësore. Ndërkaq në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike për 24 orë ka pasur 24 lindje. Nga foshnjat e porsalindura, 16 janë të gjinisë femërore dhe 9 meshkuj. Një nënë ka lindur binjakë, 11 lindje janë kryer për herë të parë, po ashtu 11 me operacion.



Limaj: Kompleksi Memorial 'Adem Jashari' do të jetësohet



PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Kryesuar nga zëvendëskryeminstri Fatmir Limaj, është mbajtur mbledhja e radhës e Komisionit Ndërmëtor për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, pjesë e të cilit janë edhe disa ministra të kabinetit qeveritar, kryetari i

Komunës së Skenderajt dhe përfaqësues të institucioneve në Kosovë. Limaj, i cili është kryesues i këtij komisioni, ka theksuar rëndësinë e madhe që ka për shtetin e Kosovës ky kompleks. Ai ka kërkuar angazhim nga të gjithë anëtarët që ecuria e projektit të finalizohet sa më

shpejt. Me gjithë punën komplekse dhe të madhe që pritet të bëhet, zëvendëskryeminstri Limaj ka thënë se janë të vendosur që t'i shkojnë deri në fund këtij projekti, ngaqë Prekazi, si vend i shenjtë jo vetëm i Kosovës, por i gjithë shqiptarëve, e meriton një projekt të

tillë. Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Bislim Zogaj, ka raportuar para komitetit për punët dhe investimet e deritashme në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" si dhe ka kërkuar të trajtohet me

urgjencë vazhdimi i punimeve në konservim dhe projektim të këtij kompleksi. Anëtarët e këtij komisioni u zotuan se do të punojnë me dinamikë të shtuar në mënyrë që sa më parë të fillojë konservimi dhe ndërtimi i Kompleksit Memorial "Adem Jashari".

Presidenti e dekoron me titullin 'Nderi i Republikës së Kosovës' këngëtarin Ilir Shaqiri

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka dekoruar të enjten me titullin 'Nderi i Republikës së Kosovës' këngëtarin Ilir Shaqiri.

Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Ilir Shaqiri dha kontribut të madh për kultivimin e këngës me motive patriotike.

"Shumë dëshmorë dhe heronj të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë përjetësuar në këngët e tij. Artistin e mirënjohur, Ilir Shaqiri, sot e dekorova me titullin

'Nderi i Republikës së Kosovës'. Ai dha kontribut të madh për kultivimin e këngës me motive patriotike", ka shkruar presidenti Thaçi.



Në Strasburg mbahet takimi i gjashtë i përbashkët i KPSA-së, BE-Kosovë

Në Strasburg kërkohet që të vazhdohet dialogu Kosovë - Serbi

Në takimin e gjashtë të Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE-Kosovë (KPSA), deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ata Parlamentit Evropian u pajtuan se progresi në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i nevojshëm në mënyrë që palët të arrijnë një marrëveshje ligjore të detyrueshme përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Në këtë drejtim kishte pikëpamje të ndryshme për taksën e vendosur nga Kosova ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 SHKURT - Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe deputetët e Parlamentit Evropian u takuan të enjten në Strasburg për takimin e gjashtë të Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE - Kosovë (KPSA). Ky takim është bashkëkryesuar nga shefi i grupit parlamentar i PDK-së,

Memli Krasniqi dhe Tonino Picula nga Parlamenti Evropian. Në këtë takim ka pasur diskutime gjithëpërfshirëse për një sërë çështjesh të rëndësishme, duke përfshirë zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE - Kosovë, procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës dhe rëndësinë e vazhdimin të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Gjithashtu, në takim u diskutuan edhe çështjet që kanë të bëjnë me gjendjen sociale dhe ekonomike në Kosovë, si dhe procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në

ushtri të rregullt.

Bashkëkryesuesit u pajtuan se progresi në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i nevojshëm në mënyrë që palët të arrijnë një marrëveshje ligjore të detyrueshme përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Në këtë drejtim, anëtarët kishin pikëpamje të ndryshme për taksën e vendosur nga Kosova ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës. Megjithatë, anëtarët ishin të mendimit se vazhdimi i dialogut është i nevojshëm dhe se ai kërkon përkushtimin e të dyja palëve. Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, anëtarët e përsëriten se Kosova i ka përbushur të gjitha obligimet e saj dhe se vendimet nga institucionet përkatëse të BE-së duhet të merren pa vonesë. Bashkëkryesuesit i mirëpritën diskutimet e hapura për të gjitha çështjet në agjendë dhe shprehën zotimet e tyre për të vazhduar marrëdhënie shumë të mira ndërmjet të dy parlamenteve. Raportuesja për liberalizimin e vizave për Kosovën në

Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, ka thënë se çështja e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe liberalizimi i vizave kanë ngecur. Ajo përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter" ka bërë thirrje që këto dy çështje të zgjidhen sa më shpejt. "Unë kam shpresuar se të dyja çështjet, dialogu në mes të Beogradit dhe Prishtinës, si dhe çështja e vizave për qytetarët e Kosovës, do të zgjidhen brenda mandatit të Parlamentit Evropian. Por, të dyja çështjet janë të bllokuara! Bëj thirrje që të veprohet nga ana e përgjegjësve", ka deklaruar Fajon, duke treguar se këtë mesazh e ka dhënë gjatë një takimi të eurodeputetëve me delegacionin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Takimi i shtatë i KPSA BE - Kosovë do të mbahet në Prishtinë më 28-29 tetor. Pjesë e delegacionit të Kosovës, pos Memli Krasniqit, ishin edhe deputetët: Elmi Reçica, Arben Gashi, Glauk Konjufca, Blerta Deliu-Kodra, Vjosa Osmani-Sadriu, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Bilall Sherifi, Time Kadrijaj dhe Visar Ymeri.



Limaj e komandanti i KFOR-it flasin për dialogun dhe sigurinë në vend

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka pritur të enjten në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Lorenzo D'Addario. Në takim Limaj dhe D'Addario kanë biseduar për zhvillimet politike në Kosovë si dhe për aspektin e sigurisë në vend. Limaj ka falënderuar komandantin e KFOR-it për

kontributin e dhënë dhe për gatishmërinë e treguar që forcat paqeruajtëse të NATO-s t'u ndihmojnë strukturave të sigurisë vendëse. Në cilësinë e bashkëkryesuesit të Delegacionit Shtetëror, Limaj e ka njoftuar ushtarakun italian për finalizimin e Platformës për dialogun me Serbinë. "Platforma është një dokument

shumë përmbajtësor që orienton dialogun që do të zhvillohet në Bruksel dhe përcakton pozicionin e shtetit të Kosovës në këtë proces", ka deklaruar Limaj. Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Lorenzo D'Addario, siguroi Limajn se KFOR-i është i gatshëm të ofrojë siguri për të gjithë qytetarët.



Kompletimi i infrastrukturës, i nevojshëm për zhvillimin e bizneseve të Drenasit

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 SHKURT - Kompletimi i infrastrukturës, krijimi i politikave favorizuese për bizneset, si dhe ulja e nivelit të burokracisë në nivel komunal rrit efikasitetin dhe mundëson për zhvillim të bizneseve operuese në Drenas. Kështu u tha në takim të organizuar me kryetarin e Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se thellimi i bashkëpunimit në mes të sektorit privat dhe institucionit të cilin ai e udhëheq reflekton në rritje të efikasitetit dhe alokim më të mirë të buxhetit të komunës. Duke potencuar se mbetet i zotuar për krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e bizneseve, Lladrovci vuri theksin mbi disa nga investimet kapitale infrastrukturore të parapara në Komunën e Drenasit si në fushën e stabilitetit energjetik e, po ashtu, edhe në atë rrugore, në mënyrë që të lehtësohet qarkullimi i njerëzve dhe i mallrave. Po

ashtu, ai tha se Komuna e Drenasit është në fazë të hartimit të planit zhvillimor dhe urbanistik në mënyrë që të mundësohet planifikim më i mirë hapësinor. Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka pohuar se njoftimi i vazhdueshëm i bizneseve mbi projektet e komunës, në të cilat njëra palë është drejtpërsëdrejti e ndikuar, ndërsa tjetra luan rol kyç në orientimin ekonomik përmes hartimit të politikave, është e domosdoshme për themelimin e strukturave të dialogut ndërsektorial, e cila pastaj përkthehet edhe në zhvillim më të hovshëm të sektorit privat dhe të hyra më të larta për komunën. Ndër të tjera, Zeka ka theksuar se iniciativa e Komunës së Drenasit për kompletimin e infrastrukturës i shërben një kauze e cila ndër vite e ka vështirësuar zgjerimin e kompanive operuese në Komunën e Drenasit.

Drejtoresha ekzekutive e Agjencisë për Zhvillim Rajonal Qendër, Mrika Macula, ka potencuar se qasja e Komunës së Drenasit për hapjen e të dhënave në lidhje me trajtimin e çështjeve të biznesit, ndër të tjera, ka rezultuar edhe me vlerësimin e kësaj komune si ajo më transparente



në Kosovë. Përveç kësaj, Macula ka thënë se Komuna e Drenasit ka arritur ta zvogëlojë numrin e procedurave burokratike gjë e cila lehtëson barrën administrative për biznese.

Kryesuesi i Komitetit të Prodhimit të Odës Amerikane, Kujtim Gjevori, duke vlerësuar nivelin e ulët të burokracisë në Komunën e Drenasit, përmendi

nevojën për ofrimin e mundësive për zhvillimin e mëtutjeshëm të bizneseve të cilat janë të angazhuara në veprimtari stimuluuese, përkatësisht në sektorin e prodhimit, i cili paraqet sektorin me hapësirën më të madhe për krijimin e vendeve të reja të punës. Ai ka theksuar se disa nga kompanitë e këtij sektori të cilat operojnë në pronat e

dhëna në shfrytëzim nga komuna e kanë të pamundur marrjen e kredive të cilat do të rezultojnë në zgjerim të tyre, pasi që nuk bëhet një ndarje nga kapitali i investuar dhe vlera e tokës së dhënë në shfrytëzim. Gjevori theksoi nevojën për inkuadrimit të sektorit privat për hartimin e planit zhvillimor dhe urbanistik të komunës.

Punëtorët e KEK-ut dhe të Shërbimit Korrektues kundërshtojnë Ligjin për pagat



PRISHTINË, 14 SHKURT - Të enjten para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës kanë protestuar Sindikata e Korporatës Energjetike të Kosovës dhe punëtorët e Shërbimit Korrektues të Kosovës, me kërkesën për rishikimin e Ligjit për pagat që, siç thonë, është i padrejtë. Zenun Sadikaj, kryetar i Sindikatës

së Punëtorëve në Shërbimin Korrektues, ka thënë se kërkesë kryesore e tyre është rritja e koeficientit nga 1.85 në 2.2 si dhe caktimi i rrezikshmërisë në 40 për qind. Ai ka thënë se punëtorët e Shërbimit Korrektues e ndiejnë veten të anashkaluar në krahasim me FSK-në, zjarrfikësit dhe Policinë e Kosovës.

Kurse Nexhat Llumnica nga Sindikata e Punëtorëve të KEK-ut ka pohuar se Ligji për pagat duhet të rishikohet. Ai i ka bërë thirrje presidentit të vendit që mos ta dekretojë Ligjin për pagat. "Kërkojmë nga presidenti Hashim Thaçi që mos të dekretojë këtë ligj, pikërisht amendamentin ku përsihet Korporata Energjetike e

Kosovës. U bëjmë thirrje institucioneve ta shikojnë këtë ligj dhe ta bëjnë në favor të ndërmarrjeve publike e jo në degradimin e tyre", ka thënë Llumnica.

Ligji për pagat i miratuar në Kuvendin e Kosovës më 2 shkurt vazhdon të kundërshtohet nga disa sindikata të punëtorëve në sektorin publik. Aktualisht në

Zyrën e Presidentit të Kosovës kanë shkruar disa ankesa nga sindikata të ndryshme, duke kërkuar mosnënshkrimin e ligjit, procedurë kjo që mundëson hyrjen në fuqi të ligjit. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se do t'i shqyrtojë me kujdes vërejtjet e të gjitha kategorive para se ta nënshkruajë ligjin.

MTI-ja dhe Klubi i Prodhueseve nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi



PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka takuar të enjten drejtorin ekzekutiv të Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxhën, me të cilin ka biseduar për mundësitë e bashkëpunimit për rritjen e konkurrencës në sektorin e prodhimit që ndikon drejtpërdrejt në krijimin e vendeve të reja të punës. Në vazhdimësinë e përkrahjes dhe forcimit të prodhuesve vendorë, ministri i MTI-së, Endrit Shala, nënshkroi memorandum bashkëpunimi me

Klubin e Prodhueseve të Kosovës për të realizuar projekte të përbashkëta që kanë për synim rritjen e konkurrencës në sektorin e prodhimit në Kosovë. Ministri Shala ka potencuar se forcimi i sektorit të prodhimit ndikon drejtpërdrejt në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në përgjithësi në zhvillimin ekonomik të vendit. "Ky bashkëpunim përfshin shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve, statistikave të cilat kanë palët dhe që nuk paraqesin fshe-

htësi që ka të bëjë me projektin e platformës 'Made in Kosova' dhe projekte të tjera në të ardhmen", ka thënë ministri Shala. Ai ka shtuar se ky memorandum parasheh mbështetjen e palëve për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me konkurrencën e kompanive vendore në tregun vendor, rajonal dhe evropian, duke mbështetur edhe organizimin e panairëve të përbashkëta për t'i promovuar bizneset prodhuese dhe produktet "Made in Kosova".

Lansohet uebfaqja për tregti ndërkombëtare

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Të enjten është lansuar uebfaqja për tregti ndërkombëtare, e ndërtuar në bashkëpunim në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Odës Ekonomike të Kosovës si dhe projektit "Rritja Ekonomike Rajonale" të financuar nga USAID dhe implementuar nga kompanitë lokale "Iron Consulting" dhe "PR Solution".

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se kjo uebfaqe ofron informacione të shumta në lidhje me procedurat e tregtimit ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, si dhe u mundëson shfrytëzuesve që t'i kuptojnë në detaje procedurat që nga themelimi i një biznesi, marrja e licencave dhe lejeve të nevojshme për realizimin e eksportit, importit apo transitit të mallrave. "Kjo uebfaqe e këtij formati është e para e këtij lloji në të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s", ka thënë ministri Shala.



Mundësi punësimi dhe trajnimi për më shumë se 500 punëkërkuës

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), ka shpallur të enjten Programin e Subvencionimit në Pagë dhe Trajnim në Punë për vitin 2019, për punëkërkuësit e regjistruar në Zyrat e Punësimit në të gjitha komunat e Kosovës. Nëpërmjet programit të Subvencionimit në Pagë dhe Trajnim në Punë do të mbështeten mbi 500 punëkërkuës

të papunë, me fokus personat e riatdhesuar. Krijimi i mundësive për punësim për punëkërkuësit në Kosovë, duke subvencionuar punëdhënësit të cilët janë të gatshëm t'i punësojnë ata në periudha afatgjata si dhe ofrimi i mundësisë së trajnimit për punëkërkuësit e papunësuar që kanë nivel të ulët arsimor dhe nuk kanë përvojë të mëparshme të punës, janë objektivat e këtyre dy skemave. Afati i aplikimit është i hapur nga data 14 deri më 28 shkurt. Punëkërkuësit mund t'i vizitojnë zyrat e punësimit për më shumë informacione rreth procedurave të aplikimit.



Hyseni: Të rinjtë e Gjakovës janë ballafaquar me plot sfida gjatë 11 vjetëve shtet

GJAKOVË, 14 SHKURT (ER) - Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës ka mbajtur të enjten një debat me të rinjtë e kësaj komune. Debatit me të cilin ka filluar vargu i aktiviteteve kulturore e sportive për nder të 11-vjetorit të pavarësisë së Kosovës ka pasur temën me titull "11+11" përmes së cilës, duke u ndërlidhur e kaluara me të ardhmen, është biseduar për sfidat e të rinjve gjatë 11 vjetëve pavarësi, angazhimin konkret të të rinjve gjatë kësaj periudhe dhe angazhimin dhe planet e tyre në

11 vjetët e ardhshëm.

Drejtoresha e kësaj drejtorie, Saranda Hyseni, ka thënë se të rinjtë e Gjakovës janë ballafaquar me plot sfida gjatë 11 vjetëve të ekzistencës së shtetit të Kosovës. Ajo ka shprehur bindjen se vitet e ardhshme do të jenë shumë më efektive dhe me perspektivë më të madhe për të rinjtë.

Përpos drejtoreshës Hyseni, pjesë e panelit dhe e debatit me të rinjtë ishin edhe Berat Thaqi, aktivist i organizatave rinore, Arbër Lleshi nga "BoneVet" dhe Freskina Mula, aktiviste e trashëgimisë kulturore.



OSBE-ja interesohet për vazhdimin e akreditimit të programeve në gjuhën turke dhe boshnjake

PRIZREN, 14 SHKURT (ER) - Prof. asoc. dr. Ismet Temaj, ushtrues detyre i rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, ka pritur të enjten në takim Nils Johannes, përfaqësues i OSBE-së në Zyrën Regionale në Prizren nga Sektori i Komuniteteve. Temë diskutimi ishte njoftimi me aspekte

teknike për procesin e akreditimit të programeve në gjuhën turke dhe boshnjake në UPZ. Rektori Temaj i ka njoftuar mysafirët me zhvillimet e fundit rreth akreditimit, duke theksuar se janë në proces të koordinimit me përfaqësuesit e Agjencisë për Akreditim, në mënyrë që të vazhdohen programet në gjuhët

e komuniteteve në Fakultetin e Edukimit dhe në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike. Ai ka shtuar se për këtë çështje presin mirëkuptim edhe nga Agjencia për Akreditim. Johannes ka theksuar se edhe ata do të interesohen për këtë çështje duke parë nevojën e komunitetit.

Malisheva, pjesë e Programit Nacional për Rini

MALISHEVË, 14 SHKURT (ER) - Në Komunën e Malishevës është prezantuar të enjten Programi Nacional për Rini para drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme. Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, Blerim Thaçi, ka thënë se ky program do të jetë kreativ për nxënësit malishevas. "Uroj që edhe nxënësit e Malishevës do të jenë pjesë e këtij programi shumë kreativ e që do të ndikojë në zbulimin e talenteve në fushat që ka për synim t'i realizojë

programi, njëkohësisht do të ndikojë edhe te mësimsdhënësit dhe prindërit për një bashkëpunim edhe më të afërt me shkollën, duke kërkuar nga drejtorët angazhim sipas dinamikave që kërkon programi të realizohet dhe nxënësit tanë të jenë pjesë e sukseseve më të larta në fushat garuese të Programit Nacional për Rini", ka thënë ai.

Ndërsa zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHt), Azem



Guri, gjatë prezantimit të Programit Nacional për Rini, ka thënë se në këtë program do të marrin pjesë të gjithë nxënësit e nivelit parauniversitar. "Prandaj

është përgjegjësi e secilit prej nesh dhe ekupeve vlerësuese t'u përmbahemi kriterëve dhe rregullave sipas udhëzuesve", ka thënë Guri. Ndërsa Gëzim Zeqiri, këshilltar i

Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, ka thënë se ky program ka dy pika themelore: gjithëpërfshirjen dhe vijueshmërinë.

Komuna e Mitrovicës ofron mbështetje për aktivitetet e Asamblesë së Fëmijëve



Mitrovicë, 14 shkurt (ER) - Udhëheqësi i Njesisë për të Drejtat e Njeriut, Fitim Rama, ka mbajtur një takim me përfaqësuesit e organizatës "Save the Children" nga Suedia dhe me fëmijët e Asamblesë Komunale. Qëllimi i këtij takimi ishte që delegacioni i organizatës "Save the Children" nga Suedia të njoftohet rreth funksionalizimit dhe aktiviteteve të fëmijëve në Asamblesën Komunale të Mitrovicës. Me këtë rast, Rama ka falënderuar mysafirët për vizitën dhe interesimin e përfaqësuesve të "Save the Children" nga Suedia, duke i njoftuar ata për

krijimin e Asamblesë së Fëmijëve dhe aktivitetet që organizohen në të mirë të fëmijëve në mbrojtje dhe promovimin e të drejtave të tyre. Drejtuesit e Asamblesë së Fëmijëve të Mitrovicës i kanë njoftuar mysafirët lidhur me themelimin e Asamblesë së tyre dhe për aktivitetet e ndryshme, sidomos edhe trajnimet të cilat i kanë ndjekur qëkur janë themeluar e deri tash. Në takim është biseduar edhe për kushtet e funksionimit të Asamblesë, mbështetjen që po ua jep komuna, por edhe për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.

Qendrat kulturore të diasporës, të domosdoshme për fuqizimin e raporteve me diasporën

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 14 SHKURT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me Drejtorinë për Hulumtime Parlamentare, Arkiv dhe Bibliotekë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka mbajtur të enjten tryezën diskutuese me temë "Organizimi i Qendrave Kulturore në Diasporë". Në hapje të kësaj tryeze është prezantuar një hulumtim parlamentar nga Liza Gashi nga OJQ Germin, që ka analizuar organizimin e qendrave kulturore të shteteve që kanë diasporë më të madhe. Po ashtu, janë prezantuar edhe praktikatat që kanë ndjekur shtetet si Armenia, Gjermania, Irlanda, Izraeli dhe Mbretëria e Bashkuar rreth funk-

sionimit të qendrave të ngjashme.

Fitore Pacolli, deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh anëtare e Komisionit për Punë të Jashtme, ka theksuar se institucionet e Kosovës dhe të Shqipërisë duhet të bashkëpunojnë ngushtë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me diasporën. Sa iu përket qendrave kulturore ajo ka thënë se duhet të mendohet një model shumë i mirë, që funksionon mirë, duke mos e shkëputur shtetin nga to.

Isni Kilaj, zëvendësministër i Ministrisë së Drejtësisë, ka theksuar se sa i përket çështjes së organizimeve kulturore të diasporës shqiptare, ka shumë probleme të trashëguara me dekada. Ai ka thënë se Kosova



nuk ka pasur mundësi të bëjë shumë sepse, sipas tij, Shqipëria nuk ka arritur të bëjë punë të duhur në të kaluarën dhe se

aktualisht të dyja vendet janë vonuar në këtë drejtim. "Tash të dy vendet kanë Ministri të Diasporës dhe jemi në rrugë të

mbarë që të kemi një ligj të përbashkët për diasporën", ka shtuar Kilaj.

Pjesë e këtij diskutimi ishin deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile të cilët u pajtuan se ngritja dhe funksionimi i mirëfilltë i qendrave të tilla është jetik për fuqizimin e raporteve me diasporën, por edhe promovimin e Kosovës nëpër botë. Po ashtu, u theksua se kjo çështje duhet të trajtohet me më tepër prioritet nga institucionet.

Kjo tryezë u organizua në kuadër të projektit për përkrahje të hulumtimeve parlamentare në Kosovë që mbështetet nga USAID-i. Qëllimi i këtij projekti është që përmes hulumtimeve parlamentare të rritet cilësia e ligjeve në vend.

Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim 'Nëna Terezë' përfiton donacion nga KFOR-i amerikan



MITROVICË, 14 SHKURT (ER) - Të enjten në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nëna Terezë" është bërë dorëzimi i donacionit të disa lodrave për fëmijë me nevoja të veçanta të cilat janë dhuruar nga Brigada Lindore Multinacionale në partneritet me OJQ "Spirit of America" dhe Drejtorinë Rajonale të Policisë së Mitrovicës së Jugut. Në këtë aktivitet i pranishëm ishte edhe kryetari i komunës, Agim Bahtiri, komandanti i Brigadës Lindore

Multinacionale, kolonel Roy Macaraeg, drejtoresha e Policisë Rajonale në Mitrovicë, Afërdita Mikullovc, drejtori për Arsim, Iset Beka, drejtori i Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nëna Terezë", Hajdar Shyti, fëmijët e kësaj shkolle, mësimdhënës dhe familjarë të shumtë. Me këtë rast kryetari Bahtiri ka falënderuar përfaqësuesit e KFOR-i amerikan dhe iniciativën e policisë për t'i ndihmuar sadopak fëmijët e kësaj shkolle, duke thënë se këta fëmijë

janë shumë të veçantë për të gjithë dhe kanë nevojë për një përkujdesje dhe respekt më të veçantë.

Ndërsa komandanti i Brigadës Lindore Multinacionale, kolonel Roy Macaraeg, ka thënë se ky donacion është realizuar në partneritet me përfaqësuesit e policisë në Mitrovicë dhe me të vetmin qëllim që në fytyrat e këtyre fëmijëve të mbizotërojë buzëqeshja. Ai ka thënë se ky donacion simbolizon vazhdimësinë e KFOR-it për ta ndihmuar shtetin e Kosovës.

Hoti: Qeveria për herë të parë ka program të garës për 340 mijë nxënës

SUHAREKË, 14 SHKURT (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, ka takuar të enjten drejtorët e shkollave të Komunës së Suharekës. Ai ka thënë se është hera e parë që Qeveria e Republikës së Kosovës ka një program për garën për 340 mijë nxënës. Në këtë takim koordinatori Hoti ka prezantuar Programin Nacional për Rininë dhe i ka njoftuar drejtorët për fillimin e garës që nga java e ardhshme. "Programi Nacional për Rininë do të organizohet në formë të garës në tri fusha: Dituri, Kreativitet Kulturor dhe Mendim

Kritik dhe në Sport. Për secilën garë kemi hartuar udhëzues për mbarëvajtjen e garës të cilët veçse janë shpërndarë nëpër shkolla. Gara në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik do të fillojë më 19 shkurt të këtij viti dhe kam besimin e plotë se ju do ta bëni më të mirën për implementimin e programit", ka deklaruar koordinatori Hoti.

I pranishëm në takimin e koordinatorit Hoti me drejtorët e shkollave të Suharekës ishte edhe kryetari i Komunës, Bali Muharremaj, i cili ka premtuar shpërblime për fituesit. "Synimi ynë është ta ndryshojmë për të mirë cilësinë e arsimit. Ne si

komunë do të japim shpërblime për të gjithë fituesit e kësaj gare në nivel shkollor dhe komunal sepse ku ka konkurrencë ka cilësi", ka thënë Muharremaj. Drejtori i DKA-së në Suharekë, Remzi Bytyçi, ka theksuar se kjo garë është e rëndësishme për nxënësit sepse për herë të parë po organizohet në mënyrë institucionale. "Është e rëndësishme që ky program do të realizohet në parimin e gjithëpërfshirjes së nxënësve. Ne si drejtori e kemi pëlqyer këtë program, shpresojmë dhe do të angazhohemi që ky program do të jetësohet në mënyrën më të mirë të mundshme", është shprehur drejtori



Bytyçi.

Programi Nacional për Rininë përfshin të gjithë nxënësit e nivelit parauniversitar dhe uni-

versitar në Republikën e Kosovës në tri fusha: Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik, Dituri dhe Sport.

Shanahan: Mbështesim një NATO të fortë

BRUKSEL, 15 SHKURT - Sekretari amerikan i Mbrojtjes në detyrë, Patrick Shanahan, tha të enjten se ai mbështet një NATO të fortë, deklarati që mund t'i qetësojë aleatët, të cilët kanë shfaqur nervozizëm rreth angazhimit të Uashingtonit ndaj aleancës.

"Shtetet e Bashkuara janë të angazhuara ndaj NATO-s; detyrimet tona në bazë të nenit 5 mbeten të hekurta dhe Amerika do të vazhdojë të udhëheqë e të mbështesë unitetin dhe sigurinë transatlantike", tha Shanahan në një

konferencë me gazetarë në Bruksel.

Paraardhësi i Shanahan, Jim Mattis, dha dorëheqje për shkak të pikëpamjeve të ndryshme nga presidenti Donald Trump. Në letërën e dorëheqjes në muajin dhjetor, Mattis vuri në dukje

hapur atë që ai e shihte si një hendek të pariparueshëm mes tij dhe presidentit Trump. Mattis kritikonte në mënyrë të nënkuptuar presidentin që, sipas tij, nuk vlerësonte aleatët të cilët kishin marrë pjesë bashkë me Shtetet e Bashkuara në disa luftëra.



Rusia, Irani dhe Turqia bisedojnë për Sirinë

Udhëheqësit e Rusisë, Iranit dhe Turqisë janë takuar të enjten në pikën turistike ruse të Soçit, për të biseduar mbi Sirinë, ndërkohë që konflikti i gjatë në atë vend po i afrohet fundit. Të tria këto vende kanë marrëdhënie rivaliteti me ShBA-në dhe e kanë mirëpritur planin e presidentit Trump për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria



MOSKË, 15 SHKURT - Udhëheqësit e Rusisë, Iranit dhe Turqisë janë takuar të enjten në pikën turistike ruse të Soçit, në brigjet e Detit të Zi, për të biseduar mbi Sirinë, ndërkohë që konflikti i gjatë në atë vend po i afrohet fundit. Të tria këto vende kanë marrëdhënie rivaliteti me Shtetet e Bashkuara dhe e kanë mirëpritur planin e presidentit Donald Trump për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria. Por, ekzistojnë pikëpyetje të mëdha se ç'do të ndodhë pas tërheqjes së Shteteve të Bashkuara nga Siria.

Tetë vjet pas fillimit të luftës, Siria mbetet e paqëndrueshme. Gjatë kësaj kohe, prania e madhe ushtarake ruse dhe e forcave milicore hezbollah me mbështetjen e Iranit, e ka ndihmuar Bashar al-Assad dhe qeverinë e tij të qëndrojë në

pushtet. Analistët thonë se planet e presidentit Trump për tërheqjen e trupave amerikane krijojnë një skenar të ri në Siri. "Një çështje shumë e rëndësishme mbetet: si duhen trajtuar kurdët e Sirisë? Rusia, sikurse dhe Irani, do të donin që kurdët të integrohen në një shtet të konsoliduar. Turqia kërkon që ndaj tyre të ushtrohet forca", thotë analisti Vladimir Evseev. Rusia, Turqia dhe Irani duan të gjejnë një gjuhë të përbashkët. Në çdo rast, ato kanë mirëpritur tërheqjen e trupave amerikane nga Siria. "Diskutuam për synimin e Shteteve të Bashkuara për tërheqjen e trupave të tyre nga pjesa verilindore e Sirisë dhe ndikimin që do të kishte kjo në situatën e Republikës Arabe të Sirisë. Nëse këto plane bëhen realitet, ky do të ishte një hap

pozitiv", tha presidenti rus Vladimir Putin. "Është shumë e rëndësishme të parandalohet krijimi i një vakuumi në pushtet pas tërheqjes së trupave amerikane", tha presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan. Takimi trepalësh po zhvillohet në qytetin turistik të Soçit. Megjithatë Shtetet e Bashkuara nuk marrin pjesë në takim, ato

janë mjaft të pranishme në bisedime. "Të tregohemi objektivë, Shtetet e Bashkuara nuk mund ta dëbojnë Rusinë nga Siria. Kjo është diçka e pamundur. As Rusia nuk ka për t'i dëbuar Shtetet e Bashkuara. Prandaj është e nevojshme që këto vende të arrijnë një marrëveshje", thotë analisti Evseev.

Gjetja e një zgjidhjeje për problemin kurd në Siri, kërcënimi nga sulmet izraelite ndaj forcave hezbollah që kanë mbështetjen e Iranit dhe lufta kundër kërcënimit terrorist nga Shteti Islamik, i dobësuar, por ende i pranishëm, janë disa nga sfidat e mëdha që do të mbeten në Siri edhe shumë kohë pas këtij raundi bisedimesh.

ShBA-ja në pritje të votës mbi sigurinë kufitare



Uashington, 15 shkurt - Ligjvënësit amerikanë pritet të votojnë të enjten mbi një marrëveshje financimi për të shmanhur një tjetër mbyllje të qeverisë, duke siguruar para për ndërtimin e barrierave dhe masave të tjera të sigurisë në kufirin me Meksikën.

Anëtarët e Kongresit dhe stafi i tyre punuan të mërkurën deri vonë për të finalizuar legjislacionin që u hartua nga një komision dypartiak, i cili duhej të

gjente gjuhën e përbashkët për çështjet e sigurisë kufitare. Komisioni ishte zgjidhja e kompromisit që i dha fund mbylljes së pjesshme 35-ditore të qeverisë. Mbyllja u shkaktua sepse republikanët dhe demokratët ishin të ndarë lidhur me kërkesën e presidentit Donald Trump për 5,7 miliardë dollarë për ndërtimin e një muri në kufirin jugor. Projektligji i ri nuk përmbush kërkesën e presidentit dhe parashikon vetëm 1,37 miliard

dollarë për barrierat kufitare përgjatë 90 kilometrave. Ai përfshin ndërkaq përmirësime teknologjike për pikat e hyrjes në kufi, më shumë doganierë dhe ndihma humanitare.

Projektligji duhet të miratohet nga Kongresi dhe të nënshkruhet nga presidenti para mesnatës të së premtes, përndryshe një e katërta e qeverisë mbetet pa financim. Trumpi tha të mërkurën se nuk e kishte marrë ende vendimin.

Barclay: Brexiti do të ndodhë me ose pa marrëveshje

LONDËR, 15 SHKURT - Britania e Madhe do të dalë nga Bashkimi Evropian në mars, pavarësisht nëse do të ketë ose jo një marrëveshje me Brukselin, ka thënë ministri britanik për Brexit-in,

Stephen Barclay. Britania e Madhe po përipiqet të bindë BE-në për ndryshimin e disa aspekteve të marrëveshjes në mënyrë që e njëjta t'i fitojë votat e deputetëve të Parlamentit britanik.

Bashkimi Evropian është shprehur kundër një marrëveshjeje të re, megjithatë zyrtarë evropianë kanë thënë se janë të hapur të ndihmojnë Britaninë për të kaluar marrëveshjen në parlament.

Ndërkohë më shumë se 40 ish-ambasadorë britanikë i kanë bërë thirrje kryeministres, Theresa May, t'i përmbahet afatit për daljen e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian më 29 mars.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E rrallë

Gjuetarët do të vrasin 2 000 hipopotamë

Aktivistët e të drejtave të kafshëve janë zemëruar shumë për vendimin e Qeverisë së Zambisë që lejon gjuhtarët të vrasin 2 000 hipopotamë. Në vitin 2016 qeveria ka njoftuar për planet për të eliminuar 400 prej kafshëve në vit duke pretenduar se ekzistonte rreziku i një përhapje antrakse (sëmundje bakteriale që prek lëkurën dhe mushkëritë).



FOTO E DITES




Në fotografi shihet një fëmijë duke marrë ndihmën mjekësore gjatë një proteste në Rripin e Gazës. /AP/

E jashtëzakonshme

Burgu i sigurisë së lartë ku do të qëndrojë El Chapo deri në fund të jetës

Ky burg ndodhet në Firenze, dy orë larg Denverit dhe është burgu i sigurisë më të lartë në Shtetet e Bashkuara. Që nga hapja në vitin 1994, asnjë i burgosur nuk është



arratisur. Pikërisht për këtë arsye është vendosur që lordi i kartelit të drogës, Joaquin "El Chapo" Guzman, do të kalojë aty pjesën tjetër të jetës.

BARSOLETA E DITËS



Dy shokë pasi pihen dhe bëhen 'dërrasë':
- Qysh e ki emrin?
- Bajram. Ti?
- Viti i Ri.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot e rëndësishme është ta kapni thelbin e gjërave pa u hapur shumë nëpër detaje që mund t'ju ç'organizojnë ditën.</p>	 <p>DEMI Karriera është ajo që ju shqetëson sot dhe e keni primare në ditën tuaj. Disa lëvizje në ambientin e punës kanë rritur ambiciet tuaja personale.</p>	 <p>BINJAKËT Sot jeni me fat si në lojë ashtu edhe në dashuri. Mund ta provoni fatin pa pasur merakun nëse do të fitoni ose jo. Yjet janë në anën tuaj.</p>	 <p>GAFORRJA Do t'i dëgjoni xhelozitë e partnerit përgjatë gjithë ditës sot. Një person i caktuar që ka ridalë nga e kaluara, ka krijuar problem në lidhjen tuaj.</p>	 <p>LUANI Sot jeni si koha, të plogësht dhe disi gri. Nuk ju pëlqen të lëvizni dhe të kryeni asnjë aktivitet. Ju ka pllakosur gjendja indiferente dhe rutina.</p>	 <p>IRGJËRESHA Ju pëlqen të lexoni në këtë periudhë dhe po i kushtoni shumë kohë blerjes së librave dhe këshillave për tituj interesantë.</p>
 <p>PESHORJA Indiferenca është arma më e mirë me disa persona të caktuar. Kështu nuk do të mund t'ju bezdisin dhe shqetësojnë më fjalët e tyre.</p>	 <p>AKREPI Edhe pse po mundoheni të tregoheni autoritar në një ambient të caktuar, nuk jeni tipat e duhur. Do t'i mblidhni të gjithë për një gotë verë më pas.</p>	 <p>SHIGJETARI Ka persona që ikin dhe ka persona të rinj që hyjnë në jetën tuaj. Raportet njerëzore janë të ndërthuara kështu dhe s'mund t'i shpëtoni as ju.</p>	 <p>BRICJAPI Sot jeni në harmoni të plotë me partnerin dhe çdo dëshirë e juaja do të bëhet realitet. Kishit kohë që nuk ishit ndjerë kështu.</p>	 <p>UJORI Një takim i rastësishëm sot do të kthehet në një miqësi të mirë pas pak kohësh. Do ta kujtoni me nostalgji këtë moment më vonë.</p>	 <p>PESHQIT Sot do të bëni dhurata për njerëzit e dashur ose për kolegët. Është dita kur ndiheni mjaft mirë dhe doni ta përçoni këtë pozitivitet.</p>

Cara Delevigne ndihmon vazhdimisht të dashurën



© NEMO / BACKGRID

Modeluesja Cara Delevigne është në lidhje dashurie me aktoren Ashley Benson. Benson dhe Delevigne janë duke jetuar në një shtëpi së bashku në Los Anxhelos. Paparacët fotografuan Bensonin duke dalë nga shtëpia ku shihej se ishte duke shkuar diku, Delevigne i ndihmonte asaj me valixhet.



I fejuari nuk e trajton Jennifer Lawrencen si fytyrë publike



Jennifer Lawrence e ka gjetur dashurinë e jetës. Një burim për revistën "People" ka thënë se një nga arsyet që aktorja 28-vjeçare dhe i fejuari i saj, drejtuesi i Galerisë së Arteve, 34-vjeçari Cooke

Maroney, janë një çift që kalojnë shumë mirë, është sepse Maroney nuk bën pjesë në botën e Hollywoodit. Sipas të njëjtit burim, Maroneyit nuk i bën përshtypje aspak bota e Hollywoodit.



Bebe Rexha nuk i ndal fotot "hot" në "Instagram"

Ajo ditë më parë pati një paraqitje të shkëlqyer në mbledhjen më të madhe të ndarjes së çmimeve muzikore, "Grammy Awards". Megjithatë nuk arriti të rrëmbejë trofe, Bebe Rexha

u shfaq në tapetin e kuq me një veshje që i mahiti të gjithë. Por, këngëtarja që sot do të sjellë një këngë të re nuk i ka ndaluar "provokimet" me fotografi të nxehta në "Instagram".



David Beckhami sërish përballë gjykatës

David Beckham mund të dalë përpara gjykatës pasi është fotografuar duke folur në telefon teksa drejton një motor. Akuzat e radhës vjen vetëm tetë javë pasi ai u dyshua se i jepte makinës me shpejtësi tej normave të lejuara. Në gjyqin e parë rezultoi se ish-ylli i futbollit nuk e kishte shkelur kodin rrugor.

Një u rrit si hebre, tjetri si nazist: Historia e binjakëve që u ndanë pas lindjes

JETA E BINJAKËVE JACK YUFE DHE OSKAR STÖHR, TË CILËT U NDANË DHE JETUAN TËRËSISHT TË NDARË QË NGA MOSHA GJASHTË MUAJSHE, JANË SHEMBULLI I PËRSOSUR PËR TË TREGUAR SE PAVARËSISHT PREJ TË GJITHAVE, NE NUK MUND TË LARGOHEMI NGA TË AFËRMIT TANË.

SIPAS NJË RRËFIMI, BËHET FJALË PËR BINJAKËT QË LINDËN NË PORTIN E SPANJËS, TRINIDAD, MË 16 JANAR TË VITIT 1933 – TË NJËJTIN VIT QË ADOLF HITLER ERDHI NË PUSHTET NË GJERMANI. PRINDËRIT E TYRE I NDANË RRUGËT GJYSMË VITI PAS LINDJES SË BINJAKËVE, SECILI DUKE MARRË NJËRIN FËMIJË.

NGA KJO PIKË, EDUKIMI I TYRE DO TË ISHTE DUKSHËM NDRYSHE, MË SË SHUMTI NË PËRVOJAT E TYRE DHE NË ATË SE SI LUFTA QË PASOI, FORMOI BOTËN RRETH TYRE.

JACK QËNDROI NË TRINIDAD, NË ATË KOHË NJË KOLONI BRITANIKE, ME BABAIN E TIJ, NJË RUMUN HEBRE.

ME NJË STACION TË FLOTËS AJRORE TË MARINËS MBRETËRORE NË ISHULLIN E TYRE DHE ANIJET NAZISTE QË “SILLESIN” NË UJËRAT QË RRETHONIN ATO, PËR TRINIDADIN, LUFTA ISHTE NË PRAG, PAVARËSISHT SE ISHTE LARG NGA FRONTI. NJË BAZË DETARE E SHBA-SË U VENDOS NË ISHULL, NË VITIN 1941.

NËNA E TYRE KATOLIKE U KTHYE NË ATDHE, DUKE MARRË OSKARIN DHE MOTRËN E TYRE MË TË MADHE NË MOSHË. KËSHTU, OSKARI U PAGËZUA ME EMRIN E NËNËS SË TIJ, STÖHR, DHE U RRIU NGA GJYSHJA E TIJ E RREPTË. SI SHUMË NGA BASHKËMOSHATARËT – DHE JO VETËM – NË GJERMANI, ATËHERË AI U BË NJË ADMIRUES I

ZJARRTË I HITLERIT DHE IDEOLOGJISË SË DEFORMUAR QË AI PREDIKONTE. OSKARI ISHTE 6 VJEÇ KUR AI U REGJISTRUA SI ANËTAR I “RINISË HITLERIANE” (ANËTARËSIMI U BË I DETYRUESHËM PËR TË GJITHË FËMIJËT NË VITIN 1936).


TË DY ISHIN TË VETËDIJSHËM SE KISHIN NJË VËLLA DIKU PËRTEJ OQEANIT, POR KALUAN 21 VITET E PARA TË JETËS SË TYRE DUKE DITUR SHUMË PAK PËR NJËRITJËTRIN.

JACK JETOI PËR NJË KOHË ME NJË TEZE NË VENEZUELË – I VETMI I AFËRM HEBRE QË MBIJETOI NË KAMPET E PËRQENDRIMIT NË EVROPË. NË MOSHËN 16 VJEÇ, AI UDHËTOI PËR NË SHETIN E SAPOFORMUAR TË IZRAELIT KU SHËRBEU NË MARINËN IZRAELITE DHE MË VONË U KTHYE NË PERËNDIM PËR T’U VENDOSUR NË SAN DIEGO TË KALIFORNISË ME BABAIN E TIJ.

TAKIMI I TYRE I PARË ISHTE I VËSHITËRË. NË 1954, JACK UDHËTOI PËR NË ESSEN, GJERMANINË PERËNDIMORE, PËR TË TAKUAR MË NË FUND BINJAKUN E TIJ. ATA NJIHNIN SHUMË PAK GJUHËN E NJËRITJËTRIT, POR OSKAR E BËRI TË QARTË SE TË QENIT HEBRE DHE TË QENIT NË IZRAEL ISHIN TEMA QË JACK DUHET T’I MBANTE LARG GJATË UDHËTIMEVE TË TIJ, PËRSHIRË BRENDA SHTËPISË SË STÖHR-IT.

KUR E PANË NJËRITJËTRIN, ISHTE POTHUAJSE DRITHËRUESE EDHE PËR FAKTIN SE ATA ISHIN VESHUR, THUAJSE NË MËNYRË TË NGJASHME. TË DY KISHIN VESHUR XHAKETA SPORTIVE TË LEHTA ME NGJYRË TË KALTËR DHE KËMISHA, E MBANIN STILIN E NJËJTË TË SYZEVE.

“I THASHË, ‘OSKAR, KE VESHUR TË



Të ndarë menjëherë pas lindjes, Jack Yufe (në të majtë) u largua, u rrit si një hebre në Trinidad, ndërsa binjaku i tij Oskar Stohr u rrit në Gjermaninë naziste ku u bashkua me të rinjtë e Hitlerit.

NJËJTËN KËMISHË DHE SYZE TË NJËTJA. PSE?”, THA JACK NË NJË DOKUMENTAR TË BBC-SË MË 1999. AI MË THA, “PSE PO VESH TË NJËJTËN GJË SI UNË?”.

PËRKUNDËR NJË RAPORTI TË GJËRAVE TË PËRBASHKËTA, PËR SHEMBULL, TË DY PËRDORNIN GISHTIN E UNAZËS PËR TË “KRUAR” KOKËN, DYSHIMI DHE ARMIQËSIMI I EDUKIMIT TË TYRE ISHTE NJË PENGESË QË ENDE NUK MUND TË TEJKALOHEJ.

VIZITA JAVORE E JACK PËRFUNDOI ME NJË SHTRËNGIM DUARSH TË FTOHTË, VETËM FORMAL. VËLLEZËRIT MBETËN THUAJSE “TË LARGËT” ME GJITHË NGJASHMËRITË E TYRE. KËSHTU, U DESHËN RRETH 25 VJET TË TJERA PËR TË BËRË NJË PËRPPJEKJE TJETËR

PËR RILIDHJEN.

NË VITIN 1979, JACK MËSOI PËR NJË STUDIM MBI BINJAKËT QË DO TË BARTESHIN NGA UNIVERSITETI I MINESOTËS. PAS BINDJES SË OSKARIT PËR T’U PAJTUAR, ATA U NËNSHKRUAN PËR TË MARRË PJESË SI NJË NGA GRUPET E PROGRAMEVE TË BINJAKËVE IDENTIKË. “NGA 137 ÇIFTE BINJAKËSH TË NDARA NË STUDIMET E DY DEKADAVE TË UNIVERSITETIT TË MINESOTËS, 56 ISHIN VËLLEZËR DHE 81 ISHIN IDENTIKË. YUFE DHE VËLLAI I TIJ, OSKAR STÖHR, U DALLUAN PËR SHKAK TË PREJARDHJEVE TË TYRE NË MËNYRË DRAMATIKE”, U THA NË STUDIM.

SHUMË SHPEJT BINJAKËT FILLUAN TË MËSONIN SE SI ISHIN VËRTET TË MAHNITSHME PËRPUTHJA E TIPAREVE TË TYRE TË PËRBASHKËTA, SI PËR SHEMBULL LEXIMI FILLIMISHT I FAQES SË FUNDIT TË NJË REVISTE DHE NJË SIMPATI PËR TË BËRË GJËRA TË TILLA SI “TËSHITJA ME TË MADHE” NË PUBLIK. ATA KISHIN NJË SHIJE TË NGJASHME ME RROBAT DHE USHQIMIN; ATA MADJE KISHIN NJË ECJE TË NGJASHME.

MEGJITHATË, KISHTE ENDE MOSMARRËVESHJE TË RËNDA MES TYRE. NJË ÇËSHTJE QË JACK DHE OSKAR MË VONË ZGJODHËN TË SHMANGNIN ISHTE POLITIKA. ATA ARGUMENTUAN PËR ÇËSHTJE TË TILLA SI ÇËSHTJA IZRAEL-PALESTINË DHE ÇËSHTJE TË TJERA TË LIDHURA. MEGJITHATË, TEMPERAMENTI I TYRE I ASHPËR NUK ISHTE I DOBISHËM PËR KONFRONTIME TË TILLA.

ÇFARË BIE NË SY ËSHTË FAKTI SE NDJEKËSIT DO TË KOMENTOJNË SE ME GJITHË SJELLJEN E TYRE TË PËRBASHKËT DHE QËNDRIMET KREJTËSISHT TË NDRYSHME PËR DISA ÇËSHTJE, VËLLEZËRIT KISHIN

NJË LLOJ TË VEÇANTË TË MARRËDHËNIES SË “DASHURISË DHE URREJTJES”.

FAMILJET E TË DY BURRAVE RANË DAKORD SE AS NUK ISHIN PERSONAT MË TË LEHTË PËR T’U PASUR NË SHTËPI, POR ATA ISHIN TË DY SHUMË TË DASHUR PËR TË AFËRMIT E TYRE.

GRUAJA E JACK, RUTH DO T’I THOSHTE ASSOCIATED PRESS: “ATA ISHIN TË HIPNOTIZUAR NGA NJËRITJËTRI, TË HIPNOTIZUAR NGA NGJASHMËRITË E TYRE, TË INTRIGUAR SE TIPARET MË TË KËQIJA QË PANË NË VETVETE U PASQYRUAN EDHE TEK TJETRI”.

E RËNDËSISHMJA, ATA ARRITËN TË RUANIN LIDHJEN E TYRE DHE MIQËSIA E TYRE ERDHI NË PËRFUNDIM ME VDEKJEN E OSKARIT PËR SHKAK TË KANCERIT TË MUSHKËRIVE NË VITIN 1997. DISA E LIDHIN SËMUNDJEN ME VITET E TIJ DUKE PUNUAR SI MINATOR.

VËLLAI I TIJ NUK MORI PJESË NË FUNERAL, DUKE NDIËR SE NGJASHMËRIA E TIJ FIZIKE DO TË ISHTE TRONDITËSE PËR ATA QË ISHIN TË PIKËLLUAR ME VDEKJEN E OSKARIT. NDËRSA JACK VDIQ NË VITIN 2015 NË MOSHËN 82 VJEÇ, PAS VUAJTJES NGA KANCERI I STOMAKUT, NË SAN DIEGO.

BIZNESI QË AI LANCOI NË VITET 1980 ISHTE ME BAZË NË EL PROGRESO, KU SHITI RROBA DHE VESHJE TË TJERA.

BINJAKËT JANË SHFAQUR NË DISA DOKUMENTARË MADJE EDHE NË LIBRA. HISTORIA E TYRE ËSHTË NJË KUJTESË BINDËSE QË NJERËZIT GJITHMONË MUND TË MËSOJNË TË PRANOJNË NJËRITJËTRIN, PA MARRË PARASYSH SA E NDRYSHME ËSHTË RRIJTJA E TYRE OSE SA NDRYSHOJNË BESIMET E TYRE IDEOLOGJIKE.



Oskar (majtas) dhe Jack (djathtas) të dy kishin një zakon të teshtinin me zë të lartë në publik, të dy lexonin revistat nga faqet e fundit në të parat

Druri më i pisët se wc, por larja nuk mjafton: 5 këshilla për higjienën

Larja me ujë nuk është e mjaftueshme për të eliminuar mikrobet potencialisht vdekjeprurëse

Duke analizuar rezultatet e një sondazhi të porositur nga rrjeti britani "Sainsbury", del se 40% e të anketuarve përdorin të njëjtin mjet prerës për mish dhe perime dhe se një në dhjetë nuk e përdorin siç duhet, ndërsa një në pesë britanikë e zëvendësojnë vetëm një herë në pesë vjet dhe një në nëntë nuk e ka bërë kurrë këtë. Të dhëna edhe më shumë alarmuese dalin në një studim tjetër, ku theksohet se bordet e kuzhinës janë ndër objektet që fshehin numrin më të madh të baktereve potencialisht vdekjeprurëse për njerëzit, duke arritur deri në 200 herë më të pista se tableta e wc.

mirë të siguroheni që dërrasa të jetë mjaft e pastër para se të përdoret, veçanërisht nëse do të përdoret për të prerë diçka që nuk do të gatuhet, siç është sandviçi".

Mos përdorni pecetë për ta fshirë

Pastrimi është thelbësor për të mbajtur bakteret larg nga dërrasa e prerjes, por për të menduar për fshirjen e mbetjeve të ushqimit me peshqir kuzhine është çdo gjë, por jo higjienike, "sepse disa studime kanë treguar se këto pëlhura shpesh



një detyrë që një pjatlarëse mund të kryejë shumë mirë duke përdorur ngrohjen, ndryshe nga uji i thjeshtë. "Por nëse nuk e keni pajisjen në fjalë, – shpjegon eksperti, – ju mund të përdorni një detergjent antibakterial: hidheni atë në dërrasën e prerjes, e lini të veprojë 5 minuta, shpëlajeni me ujë të rrjedhshëm dhe pastaj e thani dërrasën me një letër kuzhine".

Dalloni përdorimin e saj

Kur përgatiteni për të ngrënë, është e domosdoshme të përdorni dërrasa të ndryshme për ushqim të papërpunuar dhe të gatshëm, duke u kujdesur që të mos i përzini. "Mënyra më e lehtë për të shmangur konfuzionin është të përdorni dërrasa të veçanta për ushqime të destinuara", sugjeron Ackerley.

I zëvendësoni ato rregullisht

Qoftë druri apo plastike, nëse dërrasa e prerjes duket e zhveshur, e gërvishtur ose ndryshe në gjendje të keqe, është më mirë ta zëvendësoni

atë me një të re. "Bakteret dhe mbeturinat e ushqimit përfundojnë duke u fshehur në të çara të hapura në sipërfaqen e boshtit, – shpjegon ekspertja, – dhe kjo jo vetëm që e bën më të vështirë pastrimin e tyre, por gjithashtu bëhet një mjet i mundshëm i kontaminimit për ushqime të tjera".

Miti i rremë 1: bakteret vdesin shpejt

Përkundër qëllimeve më të mira, në kuzhinë ka bindje aq rrënjësore saqë është e vështirë të besohet se ato nuk korrespondojnë me të vërtetën. Në rastin konkret të dërrasave të prerjes, miti i parë për t'u dëbuar ka të bëjë me mbijetesën e mikrobeve. "Nuk është e vërtetë se ata vdesin shpejt, – thotë Ackerley, – në fakt shumë mikroorganizma të rrezikshme mund të përhapen në fragmente të ushqimit të mbetur në çarje të dërrasave të prerjes dhe të qëndrojnë atje edhe për periudha të gjata, siç është rasti i E. coli, i cili është në gjendje të qëndrojë për javë të tëra në dërrasë dhe në frigorifer".

Miti i rremë 2: të gjitha dërrasat e prerjes shkojnë në pjatlarëse

Edhe ky besim nuk korrespondon me të vërtetën. "Dërrasat prej druri mund të thyhen nëse vendosen në pjatlarëse, – thekson ekspertja, – edhe pse shpesh udhëzimet për pastrimin e tyre thonë për të përdorur ujë të nxehtë me sapun. Në vend të kësaj, është më mirë të diferencohen pllakat e prerjes sipas përdorimit.

Miti i rremë 3: Perimet nuk janë një burim ngjitës

"Kjo është ndoshta klisheja më e habitshme nga të gjitha, – thotë Lisa Ackerley – sepse perimet gjithashtu mund të përhapin baktere që mund të kontaminojnë ushqimin si E. coli dhe dërrasat e prerjes janë automjeti ideal. Shembulli klasik është prerja e një prasi dhe më pas e një domateje në të njëjtën dërrasë: në këtë mënyrë ajo shkakton në fakt një ndotje kryq në mes të një ushqimi të papërpunuar që do të gatuhet dhe një ushqim gati për t'u ngrënë i papërpunuar".



"Nëse ato nuk përdoren, pastrohen dhe ruhen siç duhet, dërrasat e prerjes janë një burim i rrezikshëm i kontaminimit të kryqëzuar", paralajmëron Lisa Ackerley, eksperte e sigurisë ushqimore. Këshilla e parë për të mbajtur larg bakteret është të mbani mend nëse diçka e ndryshme nga ushqimi është vendosur në dërrasën e prerjes, një eventualitet i mundshëm në një kuzhinë. Nëse është kështu, "është më

janë sendet më të pista në shtëpi", kujton Ackerley. Jo vetëm kaq, duke përdorur ato pas përgatitjes së mishit të papërpunuar, si dhe pulave ose perimeve, rrezikon që bakteret të kalojnë nga ushqimi në peshqir, duke kontaminuar kështu pjesën tjetër të kuzhinës.

Uji nuk mjafton

Në dërrasën e prerjes, fjala kryesore është dezinfektimi,



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

JUVENTUS - FROSINONE

DP1

AUGSBURG - BAYERN

2

LYON - GUINGAMP

1

Hyseni: Trepça '89 synon daljen në Evropë

Trepça '89 në kampionat pritet të luftojë për mbijetesë, por synime të mëdha ka në garën e Kupës për faktin se synon të dalë triumfuese dhe të marrë sërish pjesë në garat ndërkombëtare. "Synimi ynë është të dalim në Evropë, por gjithnjë duke i vlerësuar maksimalisht kundërshtarët e mbetur, konkretisht Vëllaznimit që është ekip i fortë dhe mjaft cilësor. Presim dy ndeshje të forta në gjysmëfinale, me synim që të kualifikohemi në finale dhe në fund të dalim triumfues", ka thënë Hyseni



skuadrës së Ferizajt. Futbollisti Hyseni ka thënë se në këtë ndeshje synohen tri pikët në mënyrë që skuadra nga Mitrovica të largohet nga zona e rrezikshme. "Momentalisht jemi të fokusuar në ndeshjet e kampionatit që t'i ikim sa më shumë zonës së rrezikshme. Në javën e parë na pret një ndeshje e fortë ndaj Ferizajt që, po ashtu, ka nevojë për pikë, por ne jemi përgatitur dhe jemi optimistë se atje do të shënojmë fitore dhe t'i presim më të qetë ndeshjet e ardhshme në kampionat dhe Kupë", ka shtuar ai.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 SHKURT - Skuadra që hyri në histori të futbollit të Kosovës, duke u paraqitur për herë të parë në garën e Ligës së Kampionëve, Trepça '89, po synon që edhe në edicionin e ardhshëm 2019/2020 të dalë sërish në garat evropiane. Sulmuesi

Hasan Hyseni ka thënë të enjten për "Epokën e re" se suksesi i fundit në çerekfinale të Kupës, ku arritën ta eliminojnë Prishtinën pas ekzekutimit të penalltive, ka shtuar "apetit" e 89-shit për të triumfuar në garën e Kupës, e cila automatikisht ia siguron pjesëmarrjen në garën e Ligës së Evropës. "Kemi arritur një sukses të madh që e eliminu-

am një skuadër të fortë siç është Prishtina. Kjo ka rëndësi të madhe që sezonin e nisëm me fitore. Synimi ynë është të dalim në Evropë, gjithnjë duke i vlerësuar maksimalisht kundërshtarët e mbetur, konkretisht Vëllaznimit, që është një ekip i

fortë dhe mjaft cilësor. Presim dy ndeshje të forta në gjysmëfinale, me synim që të kualifikohemi në finale dhe në fund të dalim triumfues", ka thënë Hyseni. Skuadra e Trepçës '89 ndeshjen e parë në sezonin pranveror e zhvillon të shtunën ndaj

Hasani: Skitaret tona u paraqitën mirë në 'Sarajeva 2019'

PRISHTINË, 14 SHKURT - Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka analizuar pjesëmarrjen e ekipit olimpik të Kosovës në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF) që po mbahet në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore. Kosovën e përfaqësuan skitaret Klea Vrella dhe Elba Kokaj, të cilat nuk arritën ndonjë rezultat të madh, por kryetari i KOK-ut paraqitet e tyre i vlerësoi pozitive. "Bazuar në vlerësimin e trajnerëve dhe garuesve, konkurrencës tejet të fortë, si dhe kushteve që mbretërojnë në vendin tonë, mund të themi se kishte një paraqitje e mirë e të dy skitareve. Për Kosovën është mirë që u prezantua në EYOF Sarajeva 2019, të cilat për vendin tonë ishin të dytat pas pjesëmarrjes në Erzurum 2017. Ne



EYOF Sarajeva 2019 Kosova mori pjesë me flamur sikurse çdo shtet tjetër, madje në hapjen solemne duartrokitjet e qytetarëve të Bosnjës e Hercegovinës ishin frenetike, që dëshmon respektin reciprok midis dy popujve dhe se shumica e qytetarëve nuk pajtohen me qëndrimet e politikanëve për mosnjohje të Republikës së Kosovës", ka thënë Hasani për faqen zyrtare të KOK-ut. Drejtuesit e Komitetit Olimpik të

Kosovës qëndrimin në Sarajevë e shfrytëzuan edhe për takime të ndryshme me homologët e shteteve të tjera. "Realizuar kontakte të shumta me homologët tanë, ndërsa për performancën e dy sportistëve dhe përvojën e fituar, edhe unë e ndaj mendimin me trajnerët dhe dy sportistët se të arriturat janë në proporcion me mundësitë për stërvitje dhe me kapacitetin momental të dy sportistëve. Jam i bindur se me investimet në Brezovicën e bukur dhe qendrat e tjera, sportistët tona do të shkëlqejnë në vitet në vijim", ka deklaruar Hasani. EYOF Sarajeva 2019 mbyllet sonte (e premte) mbrëma me ceremoninë mbyllëse, e flamurit e Kosovës do ta bartë skitarja Klea Vrella.

Futbolli rikthehet me ndeshjen KEK-u - Llapi

PRISHTINË, 14 SHKURT - Pas pushimit dimëror rikthehet sot (e premte), IPKO Superliga e Kosovës në futboll, me ndeshjet e xhiros së 18. Sezonin pranveror e hap ndeshja në mes të KEK-ut dhe Llapit, e cila fillon nga ora 13:30 në Obiliq. Të dyja skuadrat kanë bërë shumë ndryshime në afatin kalimtar të janarit, prandaj kjo ndeshje pritet të jetë shumë interesante. Llapi nëse dëshiron ta ndjekë titullin nuk guxon të gabojë në këtë përballje, kurse Alban Dragusha debutoi në stolin e KEK-ut. Tri ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje, përfshirë edhe derbin në mes të Dritës dhe Gjilanit dhe përballjet Ballkani - Drenica dhe Ferizaj - Trepça '89, zhvillohen të shtunën. Java e 18 do të mbyllet me dy ndeshje që zhvillohen të hënën, e ku takohen Flamurtari - Prishtina dhe Liria - Feronikeli.



Të hënën grumbullohet përfaqësuesja

PRISHTINË, 14 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës do të grumbullohet nga 18 shkurti (e hënë) në mënyrë që të përgatitet sa më mirë për duelin me Rumaninë që do të zhvillohet më 24 shkurt në orën 20:30 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në

Prishtinë në kuadër të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021". Përfaqësuesja do të jetë e vendosur në hotel "Afa" deri në ditën e zhvillimit të ndeshjes. Stërvitjet do të zhvillohen në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, prej 18 deri më 23 shkurt prej

orës 10:00-12:00 dhe prej 19:00-21:00. Kosova bën gara në Grupin B dhe në tri duelet e para ka pësuar disfata, dy herë nga Maqedonia dhe një herë nga Rumania, ndërsa e ka edhe një shans në muajin gusht për ta siguruar një vend për në

kualifikime për "Eurobasket 2021". Raundi shtesë i parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" do të zhvillohet prej 3 deri më 21 gusht, ndërsa emrat e kundërshtarëve Kosova do t'i mësojë në shkurt pas ndeshjes kundër Rumanisë.



Neymari: PSG-ja e fiton Ligën e Kampionëve

PARIS, 14 SHKURT - Neymari është i bindur se Paris Saint-Germaini do ta fitojë Ligën e Kampionëve këtë vit për faktin se ka një ekip fantastik dhe një supertrajner. Futbollisti brazilian mungoi në

ndeshjen e parë të 1/8 së finales të Ligës së Kampionëve kundër Manchester Unitedit të martën, pasi është duke e vazhduar fazën e rikuperimit nga lëndimi. Pavarësisht prej mungesës

së Neymarit dhe Edinson Cavanit, PSG-ja e mposhti Unitedin (0-2). "PSG-ja do ta fitojë Ligën e Kampionëve. PSG-ja nuk është vetëm Neymar, por ka një ekip shumë

të mirë me trajner gjeni. Pastaj, tifozët e PSG-së janë si lojtari i 12-të kur luajmë në Paris. Pa asnjë dyshim do ta fitojmë Ligën e Kampionëve dhe unë do të luaj", ka thënë Neymari.



Rahoveci për fitore ndaj Ponte Prizrenit

PRISHTINË, 14 SHKURT - Sot (premtë) dhe nesër (e shtunë) do të zhvillohen ndeshjet e xhiros së XIX në Superligën e Kosovës në basketboll. Sot janë në program dy ndeshje dhe të shtunën dy të tjera. Kryendeshja e kësaj xhiroje zhvillohet në mes të Rahovecit dhe Ponte Prizrenit me fillim nga ora 19:00 në palestrën "Shani Nushi" në Gjakovë, kurse Bashkimi është nikoqir i Lipjanit, takim ky që do të luhet me fillim nga ora 19:00 në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren. Ndërkaq të shtunën Golden Eagle Ylli do të ballafaqohet me Z Mobile Prishtinën duke filluar nga 19:00 në palestrën "13 Qershori" në Suharekë, ndërsa AFK Borea është nikoqir e Trepçës. Kjo ndeshje do të luhet nga ora 19:00 në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Duhet theksuar se Z Mobile



Prishtina vazhdon të kryesojë në renditjen tabelore me 18 ndeshje e po aq fitore me 36 pikë, kurse Golden Eagle Ylli zë pozitën e dytë me 18 ndeshje, 12 fitore e 6 humbje me 30 pikë, ndërsa

Rahoveci është në vendin e tretë me 12 fitore e 6 humbje me 30 pikë, kurse Ponte Prizreni ka 26 pikë në pozitën e katërt, aq sa ka edhe Trepça në të pestën dhe Bashkimi në të gjashtën.

Golden State gabon ndaj Portlandit

OAKLAND, 14 SHKURT - Skuadra kampione e Golden State është mundur 129-107 nga Portlandi, duke ndalur marshimin pas 16 fitoresh radhazi, edhe pse basketbollistët e Warriorsit vijnë në kryesojnë në renditjen në Perëndim. Durant e Curry realizuan nga 32 pikë secili, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Në kahun tjetër, tetë lojtarë të Portlandit realizuan mbi 10 pikë (Lillard 29), duke bërë që kolektiviteti të jetë arma kryesore e këtij triumfi (52 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit). Humbet edhe Houstoni, që u mund 121-111 nga Minnesota, sfidë ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra. Teague me 27 pikë e 12 asistime si dhe Townsi me 25 pikë bënë diferencën për Minnesotan, duke i bërë të pavlefshme 42 pikët e Hardenit për teksanët. Në Perëndim përfiton nga këto humbje skuadra e Denverit, që mundi 120-118 Sacramento, duke ngushtuar diferencat me Golden State. Millsap realizoi 25 pikë e 13 rebounde, mbështetur edhe nga Beasley me 21 pikë e Jokiçi me 20 pikë e 18 rebounde, një treshe që bëri diferencën për Denverin, surprizë këtë sezon, raporton "Telesport". Në Lindje, vijon dominimi i Torontos dhe Milwaukee, të dyja fituese dhe



kryesojnë renditjen. Kanadezët mundën 129-120 Washingtonin, takim ku shkëlqeu Siakam, që realizoi 44 pikë e 10 rebounde, lider në fushë për Toronton. Pa problem fiton edhe Milwaukee, që mundi 106-97 Indiana në fushën e kësaj të fundit. Sfidë emocionuese në minutat e fundit, me Antetokunmpo që realizoi një "triple double" (33 pikë, 19 rebounde e 11 asistime) për t'i dhënë fitoren ekipit të tij. Rikthehet te fitorja ekipi i Philadelphia, që mundi 126-111 New York (Embiid e Harris 51 pikë së bashku), ndërsa Clippersat mundën 134-107 Phoenixin, ndeshje ku u dallua Lou Williamsi me 30 pikë e 10 asistime.

REZULTATET

Cleveland - Brooklyn	139-148
Indiana - Milwaukee	97-106
Boston - Detroit	118-110
New York - Philadelphia	111-126
Toronto - Washington	129-120
Chicago - Memphis	122-110
Minnesota - Houston	121-112
Dallas - Miami	101-112
Denver - Sacramento	120-118
Clippers - Phoenix	134-107
Portland - Golden State	129-107

SHKURT

Drejtuesit e FFK-së në samitin e FIFA-s

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, të enjten kanë udhëtuar në Stamboll, ku do të marrin pjesë në Samitin dyditor të FIFA-s. Ky samit do të jetë i përqendruar në katër pika: e ardhmja e garave të FIFA-s, programi zhvillimor i FIFA-s, futbollit i femrave dhe sistemi VAR.

Avdijaj, afër Luzernit

Afati kalimtar i janarit në Zvicër mbyllet në orët e fundit të së premtes, ndërkohë që mediet vendëse njoftojnë për një marrëveshje në mes të sulmuesit Donis Avdijaj dhe Luzernit. Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës me shumë gjasa do të largohet nga holandezët e Uillemlen II për t'u transferuar te skuadra zvicerane. 22-vjeçari u pezullua pak kohë më parë nga drejtuesit për thyerje të disiplinës, teksa raportet mes tij dhe klubit duken të tendosura. Ai ka shënuar tetë gola dhe ka shërbyer në gjashtë raste në Kupë dhe kampionat gjatë kësaj periudhe, por thyerja e disiplinës është e patolerueshme për sulmuesin shqiptar.

UEFA shpjegon pse u anulua goli i Ajaksit

UEFA ka bërë me dije se goli i Ajaksit i shënuar me kokë nga Tagliafico u anulua për pozicion jashtë loje të Tadiqit. Pasi konsultoi VAR-in, gjyqtari Skomina e konsideroi pozicionin jashtë loje sulmuesin serb, i cili ndërhynte mes topit dhe portierit të Realit, Thibaut Courtois. Në profilin zyrtar në "Twitter", UEFA shkruan: "Në minutën e 38 të ndeshjes mes Ajaksit dhe Real Madridit, një gol me kokë i Nicolas Tagliafico u anulua pasi u pa në VAR. Gjyqtari vuri re se një shok i Tagliafico, Dusan Tadiq, ishte në pozicionin jashtë loje dhe ndërhynte te portieri, duke e penguar ta shikonte topin, ndërkohë që ai u godit me kokë. Për këtë, goli u anulua në mënyrë të drejtë".

Wengeri: E kam refuzuar disa herë Realin

Arsen Wenger qëndroi 22 vjet tek Arsenal, duke qenë një nga trajnerët më jetëgjatë me një ekip. Francezi e mbylli aventurën me "topçinjtë" në fund të sezonit të kaluar dhe po punon si komentator për "beIN SPORTS". Emri i tij është lakuar si kandidat për stolat e disa ekipeve të mëdha, por Wengeri nuk dëshiron të nxihet për t'u rikthyer në rolin e trajnerit. Së fundmi ai ka zbuluar disa detaje nga e kaluara e tij. Reali i Madridit është një klub i pafuzueshëm, por francezi e ka bërë, madje me shumë se një herë. Në prononcimin e dhënë për "beIN SPORTS", 69-vjeçari shpjegon edhe shkaqet e refuzimeve ndaj "Los Blancos". "E kam refuzuar Realin e Madridit më shumë se një herë. Tani nuk ekzistojnë shumë shanse për mua, por nëse do të pyesni cilindo trajner nëse do të donte të shkonte në klubin më të madh në Evropë, do të përgjigjej pozitivisht. Çdokush do të thoshte po. Isha në qendër të projektit të Arsenalit. Ndërtuam stadiumin e ri dhe kisha detyrime kundrejt klubit. Dëshironim të tregonim që ia vlen të gjithë ai investim dhe unë u garantova se do të qëndroja. Jam mjaft i kënaqur me zgjedhjen që kam bërë", ka thënë Wengeri.

Kompany, gati të sakrifikojë nga paga për rinovimin me Cityn

Vincent Kompany pritet të qëndrojë në "Etihad". Mbrojtësi veteran është gati të sakrifikojë një pjesë të pagës, duke pranuar ulje të saj, në mënyrë që të nënshkruajë një tjetër marrëveshje me Manchester Cityn. Nëse diçka e tillë realizohet, për Kompany do të ishte sezoni i 12-të që luan me fanellën e "qytetarëve". Mbrojtësi belg është një nga lojtarët kyç të ekipit të Guardiolas dhe, pavarësisht prej dëmtimeve të shumta që e kanë shoqëruar së fundmi, ai shihet si lideri i prapavijës nga tekniku spanjoll.



Autor: GAZMEND MORINA						KËNGËTARI FLORI	SHPREHJE E MENDIMEVE NË NJË VEPËR ARTISTIKE TËRTHORAZI	SHARRËZ.	ILVA MARE	KAJDE, OJNA	ZANORE	EPOKA E RE	E FRIKËSOJ SHUMË DIKË	METALI I HOLLUAR	QYTET SHQIPTAR NË GREQI TITAN
SHTAGA												SHTET (FR.) I PAGJAK			
DIJETAR FETAR MYSLIMAN											AKTORI FRANCEZ DELON (shq.) ZANORE				
MUHAMET (perkdh.)									AKTORJA FLUTURA SHKRIMTARI ZHITI (shq.)						LIBËR FILLESTAR
BIMË E VENDEVE TË NGROHTA, ME GJETHË SHUMË TË GJATA											MODELJA ÇUNMULAJ ILION LIKA				
DETI I YNI										PËREMËR PRONOR				ANITA BITRI KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.)	
KËNGËTARI RAMAZZOTTI										LLOJ VEGLE MUZIKORE TEFIK OSMANI				ZANORE KËNGËTARJA LIBOHOVA	
ORGAN I FEMRËS SË NJERIUT, GJI (sh.shq.)											VLERË, DOBI (vjet.) UÇK (ang. shk.)				
EPOKA E RE	VEGËL MUZIKORE NË TRAJTËN E NJË QYPI ME FUND TË HAPUR	E PËRZIER; E TRAZUAR	FILLOJ	KUZHINË POPULLORE PRANË XHAMISË	DJALL (hebr.)	ZANORE ALBERTO TOMBA	PJESË E SYRIT	ZHANËR I MUZIKËS QYTET I MADH NË ITALI				KËNGËTARJA GJERMANE KONOR (shqip.) PËRKET, ÇIK (bised.)			
ISH "MISS ALBANIA" KOLA						PËREMËR PRONOR ONTARIO POWER AUTHORITY				LËVIZJA POPULLORE DY BASHKËTINGËLLORE			SHEGË QYTET I MADH NË GJERMANI		
PUNËTORI I TEATRIT TË KUKULLAVE								GËZIM I MADH KËNGËTARJA MIMANI					NEON SHFUQIZIM		
SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI (sh.shq.)						GJELLË E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ TENISTI SAFIN				LETRARI MEKULI FUTBOLLISTI ARGJENTINAS HAVIER (MALAGA)				AI QË KËNDON ROK	
ALFRED KAÇINARI			KËNGËTARI KRASNIQI FUTBOLLISTI FRANCEZ DIARRA							TEKSTI QË SHËRBEU SI BAZË PËR NJË FILM MJET SHPËRTHYES					
KAFSHË E MADHE QË JETON NË OQEANË							SHPIRTI (Lat.) QELESHJA					NAIM UKA DY ZANORE			OHIO ZANORE
					RAVENA, PESCARA KËNGËTARI SHAQIRI			E DASHURA E POPAIT PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE					HARK, KTHESË LLOJ VETURE JAPONEZE		
SHPEND GRABITQAR (sh.shq. - fem.) PRODUKT I QUMËSHITIT				FORTESE NDËRTESE E BËRË ME DËRRASA				JONI ME NGARKESE NEGATIVE KËNGËTARJA LIBOHOVA						EVERTON E PESHOVA (bised.)	
EPOKA E RE	SABOTAZHI PELLG I HAPËT PËR TË GRUMBULLUAR (shq.)								AMERICA ONLINE I AFROVA (bised.)			EMËR YNI MASHKULLI U ARRATISA NGA BURGU			
PUS I UJIT						SHTET I MADH NË AZI (pashq.) REGJISORI I FAMSHËM ... BURTON				LLOJ DRURI FARISHTË				BREJTËS I VOGËL METAL ME SHKËLQIM SI TË ARGJENDIT	
MALI MË I LARTË NË TURQI							STADIUM I MADH NË BRAZIL KËNGËTARJA TARNER								SHKRIMTARI SHEHU
BASHKËT.		SKLLAV	... NOKSHIQI GRIMCOVE (bised.)				TEPSI PREJ BALTE (shq.) BOARD ADJUSTMENT ZONING				PADITËSI I SOKRATIT AGIM TEJECI				
KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON					SIPËR, KUNDREJT NËN DY BASHKËTINGËLLORE			REGJISORI ... QOSJA ISMET MUNISHI				AZEM BEJTA	KALIUM, AMPER, ZET DEM, TER		
SHTEGTAR						KËNGËTARE E VJETËR SHQIPTARE ZANORE								ZANORE EMPOLI	
LUFTËTARJA ... PALIKUQI				BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA							ARTI I VALLEVE ME FIGURA, QË LUHEN NË SKENË NGA DISA VETA				



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 5 pika (d) të Ligjit mbi arsimin në komunat e Kosovës Nr.03/L-040, Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.21/20012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil, Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr.04/L-032, Udhëzimit administrativ të MASHT-it Nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së Drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të institucioneve edukativo-arsimor dhe aftësues, më datë 15.02/2019 shpallë:

KONKURS TË BRENDSHËM Për plotësimin e vendit të lirë të punës

I. Zëvendës Drejtor i shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Emin Duraku"- Kaçanik

Drejtoria: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: (Koeficienti 7.2)

Numri i referencës së vendit të punës: 111/01-822/19

- Ndihmon Drejtorin e shkollës në menaxhimin e punëve të përgjithshme të institucionit, në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave,
- Ndihmon Drejtorin e shkollës rreth menaxhimit të stafit e SHFMU-së, organizimit të punëve përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar shërbime cilësore,
- Ndihmon Drejtorin e shkollës në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës,
- Ndihmon Drejtorin e shkollës lidhur me menaxhimin e ofrimit të shërbimeve në fushën e edukimit dhe arsimit fillor,
- Ndihmon Drejtorin e shkollës gjatë zhvillimit të politikave në lidhje me edukimin dhe arsimin fillor dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre,
- Në bashkëpunim me drejtorin e shkollës koordinon punën me organe tjera përkatëse rreth çështjeve ligjore dhe bashkëpunon me organet tjera lidhur me edukimin dhe arsimin fillor,
- Ndihmon Drejtorin e shkollës në vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahe zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kerkuara,
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret, të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Procedura e konkurimit: është e brendshme për të punësuarit të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhetribute tjera që kërkohen:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240ECTS/-4 vite të shkollimit universitar), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullave tjera ligjore,
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit,
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim dhe
- Të kenë së paku tri vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.


Kohëzgjatja e emërimit : periudha e kontratës 4 vjet me mundësi vazhdimi.

Aplikacionit duhet t'i bashkëgjiten këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes,
- Diplomën e Fakultetit të kryer për nivelin përkatës,
- Dëshmi për përvojen e punës,
- Portfolion profesionale (shih shtojcën G të udhëzimit administrativ të MASHT-it Nr.08/2014),
- Letër referencë nga një institucion publik -kredibil (duhet të kenë përbajtur dëshmuar për punën dhe angazhimet paraprake),
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të MASHT-it,
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore,
- Dëshminë se nuk është nën hetime.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë" "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik. Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimorës -Zyra e pranimit, kati përtheshë dhe në web-faqen komunale . Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Opština Kaçanik, u saglasnost člana 5 tačka (d) Zakona Obrazovanja u Opštinama Kosova Br.03/L-040, Zakona Br.03/L-149 Civilne Službe Republike Kosova i Pravilnika Br.21/20012 unapredjenje u karijeri civilnih službenika, Zakona preduniverzitetskog obrazovanja Br.04/L-032, Administrativnog Uputstva MONT-a Br.08/2014 o procedurama i kriterijama izabranja Direktora i zamenik direktora vaspitno obrazovnih institucija, od 15.02.2019 objavljuje ovaj :

UNUTRAŠNJI KONKURS za popunjavanje upraznjenog mesta

I Zamenik Direktor osnovne srednjo niske škole "Emin Duraku"- Kaçanik

Uprava: Uprava Obrazovanja i Kulture

Funkcionalna kategorija i grada radnog mesta: (Koeficient 7.2)

Broj reference radnog mesta: 111/01-822/19

- Pomaže Direktora škole u menažiranju opštih poslova institucije, u odredjivanju objekta i razvoju plana rada za ispunjavanje ovih objekta
- Pomaže Direktora škole oko menažiranja stafa ONSŠ organizovanje rada preko podele zadataka kod sledbenika, pruži uputstva i monitorira rad stafa za ponudu kvalitetne usluge,
- Pomaže Direktora škole u proceni unutrašnjih procesa i procedura i preporučuje, izmene popravljaja sa ciljem podizanja kvaliteta i efikasiteta rada.,
- Pomaže Direktora škole u vezi menažiranja ponudjenja usluga u polju vaspitanja i osnovnog obrazovanja,
- Pomaže Direktora škole u razvoju politika u vezi vaspitanja i osnovnog obrazovanja i nadgleda njihovo sprovođenje,
- U saradnji sa Direktorom škole koordinira rad sa ostalim organima oko zakonskih pitanja i saradjuje sa sa ostalim organima vaspitanja i osnovnog obrazovanja,
- Pomaže Direktora škole za redovnu procenu stafa pod njegovom nadglednjom i podržava njihov razvoj preko trajniranja za obavljanje njihovih zadataka u saglasnosti sa zahtevanim standardima,
- Vrši i ostale zadatke u saglasnosti sa zakonom i pravilnicima koje mogu da se povremeno na opravdan nacin da se traže od strane nadležnog..

Procedura konkurisanja: unutrašnja za zaposlene koji ispunjavaju kriterije konkursa.

Školska sprema, Sposobnosti, iskustvo i ostali atributi koji se traže:


- Da su državljani Republike Kosova
- Da imaju završenu najmanje univerzitetsko obrazovanje osnovnog nivoa (najmanje kvalifikacija od j 240ECTS/-4 godine univerzitetskog obrazovanja), priznatih profila za poziciju nastavnika prema uputstvu za licenciranje nastavnika i normativa o zapošljavanju nastavnog kadra i ostalih zakonskih pravila.
- Da imaju redovnu licencu nastavnika i oni koji su u proceduri licenciranja
- Dauspešno imaju završenu jedan akreditovani program profesionalnog kvalifikovanja za rukovođenje, administratovanje i menažiranje i
- Da imaju najmanje tri godine iskustva u obrazovanju ili institucijama obrazovanja.

Vremetranje imenovanja : period ugovora 4 godine sa mogućnostima produženja.

Aplikaciji treba priložiti ove dokumente:

- Izvod rođenja,
- Diplomu završenog fakulteta za doticni nivo,
- Dokaz radnog iskustva,
- Profesionalni Portfolio (vidi aneks G administrativnog uputstva MONT-a Br.08/2014.
- Referentno pismo jedne javne institucije-kredibilne (treba da imaju dokazni sadržaj za predhodni rad i angazman),
- Razvojni plan vaspitno-obrazovne institucije i sposobne prema uputstvama MONT-a.
- Zdravstveno uverenje izdato od jedne javne zdravstvene institucije kojom se dokazuje njegovo zdravstveno stanje,
- Dokaz da nije pod istragom.

aplikacije svih lica muškog i ženskog roda svih zajednica Kosova" "Zajednice manjine i njihovi pripadnici imaju pravo za pravilno i proporcionalno predstavljanje u organima civilne službe javne centralne i lokalne administracije, kako se specificira u članu 11 paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 Civilne Službe Republike Kosova" Konkurs ostaje otvoren 8 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informiranja. Formulari Aplikacija uzimaju se i dostave u službi skriptarnice -Prijemno odeljenje, prizemlje i na web stranici opštine. Zahtevodostavljene posle isteka roka neće se primati. Nekompletirani zahtevi mogu se odbiti. Zbog velikog broja primljenih zahteva, kontaktirace se samo kandidati izabrani u tesnoj listi.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333**

**American
Taste**

**SINCE
1905**



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Af Metal Technology" Grabanicë, Klinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të metaleve në Grabanicë komuna e Klinës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.03.2019 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Bistrica" i cili gjendet në hyrje të fshatit Grabanicë komuna e Klinës do të organizohet debat publik nga kompania "Af Metal Technology" Grabanicë, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të metaleve në Grabanicë komuna e Klinës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania NTH "Bujar Commerce" Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:


DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thertoren, depon dhe përpunimin e mishit në Lubizhdë komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.03.2019 në ora 11:00 në hapësirat e objektit të kompanisë "Bujar Commerce" i cili gjendet në rrugën magjistrale Prizren-Suhareke në fshatin Lubizhdë komuna e Prizrenit do të organizohet debat publik nga kompania NTH "Bujar Commerce" Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thertoren, depon dhe përpunimin e mishit në Lubizhdë komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REBUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

Ndërmarrja Publike Lokale
"Stacioni i Autobusëve "Sh.A. FERIZAJ"

Kryeshefi Ekzekutiv i Stacioni Autobosëve Sh.a.Ferizaj në bazë të nenit 16 pika 1 të Statutit të kompanisë, Ligjit të Punës nr.03.L-212 neni 8 dhe 10 pika 2.2 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Organogramin, lidhur me plotësimin e vendit të punës,shpallë:

KONKURS

ME KOHË TË CAKTUAR 1 VJET ME MUNDËSI VAZHDIMI

Për vendin e punës

1.(1) Dispiçer-Biletar

Kualifikimet e nevojshme:

Kërkesën dhe CV


1. Shkolla e mesme
2. Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipit
3. Shkathësi të shkëlqyeshëm komunikues
4. Shkathësi të shkëlqyeshëm për kompjuter (Çertifikatën nga ndonji institucion kredibil).
5. Përovja e punës është e dëshirueshme
6. Dëshmi se nuk është nën hetime

Vlerësimi dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim. Lartësia e pagës përcaktohet në harmoni me politikat e Kompanisë. Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionin në zyrë të kompanisë N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A në Ferizaj dhe po në të njëjtin vend edhe mund të dorëzojnë aplikacionet.

Dokumentacioni i pa kompletuar nuk do të konsiderohet të vlefshëm. Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë, pas seleksionimit të dokumentacionit të paraqitur nga komisioni përkatës.

Afati për dorëzimin e aplikacionit është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit prej orës 8-16:00.

NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.
Ferizaj, më 14.02.2019
Kryeshefi Ekzekutiv



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Misin Ukë Mataj, shpallë të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të UP-së, me nr. 4021- III-1981.

► Venera Shala shpallë të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Koxhë Kadri Prishtina" të lëshuar në viti 1995.

► Allmen Bajra shpallë të pavlefshme dëftesat nga klasa -I- deri -IX- të lëshuar nga shkolla fillore "Ekrem Rexha" Lubizhdë-Prizren.

► Nexhat Smakiqi shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz të banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane - Ministry of Defense



BËHU REKRUT I FSK-së!

BËHU USHTAR I REPUBLIKËS SË KOSOVËS!

KONKURS

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës shpall konkurs për pranimin e rekrutëve të rinj – ushtarë aktivë për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Konkursi do të jetë i hapur prej datës 11 deri më 22 shkurt 2019.

Formularët për aplikim janë në dispozicion në të gjitha kazernat e FSK-së, si dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, www.mksf-rks.org, apo www.rks-gov.net/mfsk.

Ministria e Mbrojtjes ju shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet e të rinjve pa dallim nga përkatësia e tyre etnike, gjinore dhe racore.



Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht në të gjitha kazernat e FSK-së,
çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-199, 038-603-355.